	TOTALI	3,778,394	4,536,440	4,728,492	4,932,292

PBA Parashikimi i shpenzimeve

NJVQV: 146- Bashkia Vlorë

PBA : 2026 - 2028

Kodi	Programet	Plan 2025			Plan 2026			Plan 2027			Plan 2028		
		600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231	600-601	602-606	230-231
1110	Planifikimi, Menaxhimi Administrimi	508,472	652,938	506,840	597,783	649,830	701,053	621,696	675,823	739,689	646,564	702,856	783,935
10140	Perkujdesi Social	75,115	19,305	4,500	79,132	20,530	2,000	82,297	21,351	2,080	85,589	22,205	2,163
5100	Menaxhimi i Mbetjeve	47,601	88,283	450	437,852	249,209	154,600	455,366	259,177	160,784	473,581	269,544	167,215
6260	Sherbimet Publike Vendore	470,601	168,711	5,751	138,195	201,554	72,560	143,723	209,616	75,462	149,472	218,001	78,481
8130	Sport dhe Argetim	21,245	47,830	3,000	20,912	54,310	0	21,748	56,482	0	22,618	58,742	0
8220	Trashegimia Kulturore, Eventet Artistike dhe Kulturore	76,195	29,270	10,300	77,571	44,445	8,700	80,674	46,223	9,048	83,901	48,072	9,410
3280	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja	72,967	14,600	0	76,013	18,900	0	79,054	19,656	0	82,216	20,442	0
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit	19,035	27,644	0	23,404	27,479	0	24,340	28,578	0	25,314	29,721	0
4260	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	17,094	400	0	17,328	1,200	0	18,021	1,248	0	18,742	1,298	0
4520	Rrjeti Rrugor Rural	3,449	0	0	3,553	2000	0	3,695	2080	0	3,843	2163	0
9120	Arsimi Baze perfshire Parashkollorin	434,914	72,540	301,084	460,616	85,171	231,322	479,041	88,578	240,575	498,202	92,121	250,198
9230	Arsimi I Mesem I Pergjithshem	56,481	12,479	0	67,629	11,589	0	70,334	12,053	0	73,148	12,535	0
	TOTALI	1,803,169	1,134,000	831,925	1,999,988	1,366,217	1,170,235	2,079,989	1,420,865	1,227,638	2,163,190	1,477,700	1,291,402
	Kontrolli		3,769,094			4,536,440			4,728,492			4,932,292	

17. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË VLORE PËR VITIN 2026

I. Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i Buxhetit 2026.

Buxheti është tërësia e të ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore të planifikuar, miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e bashkisë. Më tej buxheti vendor përfshin një fond rezerve dhe një fond kontigjence, e mbi bazën e këtyre parimeve, ky buxhet është hartuar në zbatim të legjislacionit të mëposhtëm:

- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c;
- Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar
- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësisë së Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 65.
- Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2, date 28.02.2025 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Plotesues) nr.19 datë 10.07.2025 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028”
- V.K.B Nr. 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksionet e deleguara -2026”.
- V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024” i ndryshuar, shprehur i ligjshëm nga prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 12.12.2023.
- Ligje dhe akte të tjera ligjore.

PRIORITETET E QYTETARËVE TË BASHKISË VLORE PËR BUXHETIN 2026

Ky dokument financiar është mbështetur mbi parimin e transparencës së përdorimit të fondeve publike pasi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 16 pika 1 *“Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes”* të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për *“Vetëqeverisjen Vendore”* si dhe të ligjit Nr. 68, date 27.04.2017 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, Neni 5, pika ç *“Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.”*, sipas një kalendari të hollësishëm, Administrata e Bashkisë Vlorë ka realizuar një sërë konsultimesh me komunitetin dhe grupe të ndryshme interesi. Janë pikërisht këto takime që kanë qenë një burim i rëndësishëm informacioni mbi të cilin janë përcaktuar edhe prioritet e bashkisë për vitin 2026.

Me qëllim pasjen e një panorame të përgjithshëm mbi prioritet e përcaktuara nga qytetarët gjatë dëgjësave publike në vijim janë paraqitur si në formë statistikore edhe narrative informacioni dhe çështjet e trajtuara, duke u mbështetur në proces verbalit e mbajtura prej personave përgjegjës. Në vijim paraqiten të dhënat demografike mbi pjesëmarrësit, të dhënat statistikore të çështjeve të ngritura sipas kategorive dhe nënkategorive të buxhetit, për të përmbyllur me sugjerimet specifike dhe të hollësishme të ngritura nga qytetarët në çdo dëgjësë publike.

1. Të dhëna demografike të qytetarëve pjesëmarrës

Në një shtrirje kohore prej rreth 2 javëve u realizuan 9 konsultime publike, në 4 Njësitë administrative të Bashkisë Vlorë si dhe në 5 rajonet e qytetit, ku morrën pjesë **1200** qytetarë,


Përsa i përket shpërndarjes demografike të pjesëmarrësve sipas vendbanimit, referuar edhe numrit të banorëve, pjesa më e madhe e tyre i përkisnin Bashkisë Vlorë, për të vijuar më tej me Njësinë Administrative Novoselë, Njësinë Administrative Orikum, Njësia Administrative Shushicë Njësinë dhe në fund Administrative Qendër.

Kategoritë dhe nënkategoritë e buxhetit

Problematikat dhe çështjet e propozuara prej qytetarëve gjatë konsultimeve publike mbi projekt buxhetin e vitit 2026 në vijim janë të grupuara sipas kategorive të buxhetit ku në rend kronologjik janë renditur prej kategorisë që zë peshën më të madhe në përqindje tek problematika që zë peshën më të vogël. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike vlerësuar nga 30% e qytetarëve, ndjekur nga Zhvillimi Ekonomik Vendor me 15% , Shërbimet Sociale vlerësohen nga 15 % e qytetarëve ndërsa investimet në Arsim vlerësohen nga 15% e individëve, Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pyjet dhe Kullotat vlerësohen si zëra të rëndësishëm në buxhetin bashkiak nga 10% e qytetarëve, Mbrojtja e Mjedisit vlerësuar nga 5% e qytetarëve,

për të përfunduar me kategorinë Kultura, Sporti dhe Shërbimet Argëtuese me 10% të qytetarëve.

Nga analiza e prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve të shprehura përmes komenteve në degjësat publike prioritete kryesore zgjedhur nga banorët, rezulton një shpërndarje në zërat e buxhetit si në tabelë:



3 . Sugjerimet specifike të qytetarëve të Vlorës;

Sugjerimet specifike të qytetarëve të Vlorës që kanë marrë pjesë në votimin online.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë të detajuar propozimet e paraqitura për sejcilin rajon dhe njësi administrative, vlen të theksohet se janë përmendur vetëm kërkesat të cilat hyjnë në kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtëpërdrejtë e njësisë së vetqeverisjes vendore.

- **Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit në qytet ose njësi administrative.**

Nga dëgjesat publike sipas rajoneve dhe njësive dolën problemet e mëposhtme të cilat janë marrë në konsideratë në hartimin e projekt buxhetit. Kërkesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:

Në Rajonin nr.1

1. Të shtrohet hekurudha, të bëhet rrugë nga tuneli te fabrika e çimentos
2. Rruga “Bilbil Ceno”, duhet asfaltuar 80 m
3. Kërkohet një investim te liqeni, që mbledh ujrat (Gropë septike)
4. Nga ujrat e shiut tek përroi i Llonxhës, të merren masa pasi mbytet lagjia Muradie
5. Rikonstruksioni i shkallëve të Kuzum Baba-së
6. Në aksin Vlorë Skelë, të krijohen xhepat për autobuzet pasi pengohet trafiku
7. “Topat” në sheshin e Flamurit, të shihet projekti për vendosjen e tyre
8. Të shikohet mundësia ti kthehet identiteti sheshit te “3 racat”

9. Mungesa e tualeteve publike
10. Një forcë policore të jetë prezent në rrugën "Justin Godart"
11. Rikonstruksioni i shkollës 28 Nëntori
12. Pastrimi i kanaleve pas shkollës "28 Nëntori"
13. Problem në rrugën "Teme Alushi" një shtyllë druri, puseta e prishur, problem i ujrave që krijojnë përmytje
14. Të shikohet ndricimi në të gjithë rajonin
15. Te ish-Greva problem rruga e ngushtë, problemi i taksive, në të dyja anët parkime
16. Problem te rrugica te "Ini", rrugica lartë , janë zënë nga banorët. Të bëhet një planifikim për atë rrugicë.

Në Rajonin nr.2

1. Në lagjen "10 korriku", rrugët e lagjes të pashtuara
2. Prania e qenve të rrugës (shqetësim për shumë banorë)
3. Problem pastrimi i kanaleve dhe kolektorëve
4. Mungon ndricimi brenda lagjes
5. Mungesa e vënies së rrjetave në pallatet e reja , që janë duke zhvilluar punimet
6. Ngritja e pallateve mbi kolektor
7. Shumë problem vendosja e strehëzës në qendër të lagjes si dhe pastrimi
8. Zënia e rrugës pas shkollës "Ismail Qemali" nga ndërtimet e shumta
9. Rrugët në të gjitha lagjet duhen rikonstruktuar
10. Ndërtimet pa leje nuk kanë ruajtur distancat në ndërtim (Tek rrapi)
11. Mbetjet përgjatë gjithë rrugëve. Duhet shtuar koshat e mbeturinave
12. Mungesa e administratorëve të pallatit
13. Pastrimi i rrugës te ura (Salvadori) dhe të bëhet ndërhyrje nga të dyja anët
14. Mungesa e rrugës te Tiku&Maku
15. Përgjatë rrugës së shkollës Tregtare, tek Kontinentali mungojnë koshat
16. Zënia e hapësirave publike
17. Shumë problem parkimi për bizneset në Lungomare
18. Në lagjen "10 korriku" mungon ndricimi, rrugët janë të zëna, zgjerojnë gardhet
19. Midis shkollës Mjekësore dhe Universitetit "Ismail Qemali", plehrat ngjitur me kalçeton
20. Në lagjen Pavarësia shumë problem pastrimi
21. Orari i shërbimit urban të Unazës është shumë i kufizuar
22. Rruga pas "7 Pallateve" një pjesë e pashtuar

Në Rajonin nr.3

1. Te "Kali I trojës" rikonstruksioni i Lulishtes
2. Amfiteatri në këndin e lojrave, është lënë jashtë kontrollit
3. Mungesa e tualeteve mbas Universitetit
4. Rruga Transballkanike pa transport publik
5. Mungesa e ujit në çezmat përgjatë bulevardit
6. Rruga e pakalueshme, shumë e keqe mbas "3 Racave"
7. Amortizimi i pallateve të vjetra te shkolla "Lef Sallata"
8. Problemi i lavazhove Brenda lagjeve
9. Aksi rrugor Alpet – Metabo , 80 m pa asfaltuar
10. Mungesa e semaforëve
11. Vendosja e orareve të autobuzëve në stacione
12. Pranë Kishës Katolike, përmytet rruga nga shirat, duhet tubo shkarkimi
13. Rruga mbas "Jumbo" , shumë e keqe
14. Shumë problem parkimi në rrugët e qytetit për banorët rezidentë
15. Mungesa e administratorëve të pallateve
16. Heqja e stolave tek lulishtja e "Kalit të Trojës"
17. Në zonën e ish-Kombinatit kërkojnë të bëhen disa rrugë për dalje në rrugët kryesore, në boulevard dhe Transballkanike
18. Mungojnë ambientet e gjelbëruara
19. Bllokimi i pallateve mbas kopshtit Binjakët, ekzistenca e objekteve të palegalizuara
20. Tek blloku I Orizit mungon ndricimi, mungojnë stolat dhe lulishte
21. Propozim për ngritjen e një çerdheje tek blloku Conad
22. Problem i adrestarit, vendosja e adresave

Në Rajonin nr.4

1. Garazhet shumë problematike, të mbushura me ujë
2. Puseta të bllokuara ose pakapak
3. Zaptuar hapësira e lulishtes, kthyer në parkim
4. Problem ndriçimi të rruga "Kongresi I Manastirit"
5. Rruga "Mehmet Alemi" duhet asfaltuar
6. Të bëhen lulishte në kopshtet publike
7. Problem i ujrave të zeza
8. Problem i qenve të rrugës
9. Problem pastrimi tek rruga "Mis Durham"
10. Konfiskimi i shtëpive të braktitura
11. Problemi i gabinave elektrike që qëndrojnë të hapura
12. Problemi i zënies së hapësirave (parkimeve) me makinat e lëna prej kohësh
13. Gardhet e Tranballkanikes, daljet janë shumë të vogla
14. Propozim për mbulimin për kanalin e Naunkës
15. Segmenti Mapo – Gjykata e Apelit në rrugën Enver Jaho, rruga me gropa, gjendja shumë e keqe
16. Problem shërbimi urban
17. Trotuarët e prishur
18. Në rrugën "Riza Salati", rrugicë e ngushtë, banojnë 34 familje. Rruga e paasfaltuar, janë zënë rrugët nga ndërtimet.
19. Mungesa e stolave midis pallateve 1100 dhe 1011
20. Zgjerimi ures tek rruga Fan Noli

Në Rajonin nr.5

1. Rikonstruksioni i rrugës "Zenel Gjoleka", tek Ujësjellësi
2. Rikonstruksioni në rrugët e lagjes Kushtrimi
3. Mungesa e ujit të pijshëm tek zona e Pusit të Mezinit, tek Divizioni dhe thuasj në të gjitha lagjet e Rajonit
4. Prishja e mureve rrethues që pengojnë qarkullimin
5. Rruga për te divizoni
6. Rruga për te KSHA
7. Rruga "Dervish Hekali"
8. Mungon ndriçimi në rrugën Leonidha Naco
9. Sistemimi i bllokut të pallatet
10. Rruga "Osman Haxhiu" tek Credins
11. Rruga në Pus Mezin, kërkon thjesht mbushje
12. Problem kanalizimet në lagjen Kushtrim

Njësia Administrative Orikum

1. Rruga është e keqe, pompat nuk punojnë, ujrë të zeza janë mbi rrugë, ndriçimi mungon
2. Të rishikohet SPL, paguhet 400lek/m2 duhet të jete 100 lek/m2
3. Fondi i zhillimit ka lënë pallatet pa përfunduar
4. Rruga e Lungomares ka ngelur gjysëm
5. Problem me ujësjellësin, mungesa në furnizim. Propozim linja e ujit për rrugën Ali Cani
6. Mungon një tabelë në Rradhimë për orientimin e turistëve
7. Në Fushë-Dukat mungon uji i pijshëm
8. Duhet riasfaltimi i qendrës dhe ndriçimi
9. Lirimi i hapësirave publike pranë pallateve

NJA Shushicë

1. Kanalet janë të papastruara, kulluset dhe vaditëset. Hapjen e rrugëve rurale për të shërbyer zjarfikësës dhe ambulancës
2. Të rregullohet rruga dhe makinat e tonazhit të rende të kalojnë nga Xhuherina
3. Mungesa e ujit të pijshëm në Llakatund, dhe mungesa e ujit për vaditje
4. Probleme me ndricimin dhe trotuaret
5. Kolektorët të papastuar

NJA Novoselë

1. Rrugët e brendshme të Fshatit janë pa ndricim
2. Rrugët e brendshme të Delisufit kanë nevojë për restaurim si dhe kanalet kulluese

3. Rregullimi i rrugës së brendshme në Mifol
4. Riasfaltimi i rrugës së brendshme Dëllënjë. Lidhja e ujit të pijshëm nuk është bërë
5. Në Cerkovinë nuk ka ujë të pijshëm, depo nuk e furnizon dot. Rrugët e brendshme janë shumë keq
6. Kërkojnë 6 turbina 1000 për ujin, që të shkojë në parcel për 15 familje
7. Duhet një skrep për tu ardhur në ndihmë banorëve.
8. Në fshatin Skrofotinë duhen 700 m tubo për ujë të pijshëm, si dhe 100 rrugë për varrezat
9. Kopshti ka nevojë për rikonstruksion
10. Novosela ka nevojë për kanale kulluese
11. Në Akërnë ka problem me ujësjellësin
12. Rruga e varrezave ka nevojë për ndërhyrje
13. Në Bishan ka nevojë për kanale kulluese
14. Shtrimi i rruges Fitore – Bishan, 3 km
15. Mungesa e transportit publik
16. Fshati Fitore ka nevojë për ujra të bardha si dhe ndricim
17. Fshati Trevllazër ka problem me ujësjellësin si dhe rikonstruksionin e rrugëve
18. Fshati Poro ka problem kullumin e ujit, nuk kalojnë dot me makine
19. Problem me legalizimet

Nj.A Qender

1. Rrugët e Kërkovës kanë nevojë për riasfaltim
2. Duhet një skrep për hapjen e rrugëve të parcelave
3. Riasfaltimi i rrugës Kërkovë – Oshtimë
4. Rruga te depua e UKV dhe e varrezave kanë nevojë për riasfaltim
5. Mungon ndricimi në Bestrovë
6. Në fshatin Zvërnec mungon uji i pijshëm, furnizohen vetëm 30 minuta gjatë ditës
7. Asfaltim i rrugës së brendshme Zvërnec
8. Rregullimi i çezmes së vjetër
9. Në fshatin Alikokë riasfaltim një pjesë rrugë 200m
10. Zëvendësimi i selive të djegura në Hoshtimë
11. Gjysma e fshatit Hoshtimë ka nevojë për ndriçim dhe riasfaltim të rrugëve
12. Në panaja ka mungesë të ujit të pijshëm
13. Riasfaltim i rrugës së varrezave Babicë e Vogël
14. Në fshatin Alikokë dhe Babicë ka nevojë për riasfaltim
15. Në Panaja duhet tokë për varrezat e fshatit
16. Në fshatin Xhuherinë rrugët e brendshme janë shumë urgjente, ndricimi nuk është bërë
17. Vendosja e transportit publik deri te Manastiri i Zvërnecit
18. Në Bestrovë mungesë uji prej 2 muajsh, rruga e liqenit e pakalueshem
19. Riasfaltimi i rrugës në fshatin Kërkovë

• **Kanalizimi i Ujërave të Zeza/ kanalet kulluese dhe vaditëse**

Në takimet e realizuara në njësitë administrative për një pjesë të banorëve mbetet shqetësim sistemi i kanaleve kulluese dhe vaditëse kjo edhe për vetë faktin që bujqësia është një prej pilareve ekonomik të zonave respektive si pastrimi i kanaleve kulluese në fshatin Novoselë, kanalet vaditëse në fshatin Mifol, sistemi kullues dhe vaditës në fshatin Pish-Poro. Ndërkohë që përsa i përket kanaleve të ujërave të zeza qytetarët kërkonin jo vetëm ndërtimin dhe përmirësimin e sistemit si në Rrugën “Dhimitër Konomi”, Lagjjen “Hajro Çakëri”, por edhe pastrimin prej ndotjeve ku shpesh herë ishin edhe inerte.

• **Pastrimi dhe Gjelbërimi**

Për një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve përmirësimi i cilësisë së pastrimit të qytetit mbetet prioritet. Veçanërisht gjatë sezonit turistik ku shumëfishohet numri i vizitorëve në

qytet qytetarët dhe bizneset kërkonin që të shpeshtohej shërbimi i pastrimit në qytet. Një tjetër shqetësim i qytetarëve ishte shpeshtimi i njësive të grumbullimit të mbeturinave (koshave) si dhe ripëshpërndarje e tyre. Më specifikisht: pastrimi i pyllit të sodës veçanërisht nga mbetetjet e fasonerive dhe bizneseve; pastrimi tek Ura e Zogës (takimet e qytetarëve në rajonin 4), pastrimin i kanaleve të ndryshme në qytet (Fabrika e Çimentos, në lagjen 24 “Maji”, Rajoni 5), pastrimi i kolektorëve në njësitë administrative. Pastrimi i zonës së Ish Kinemasë “Ali Demi” në Rajonin nr.1. Krasitja e pemëve të ndryshme në disa akse të rrugëve të qytetit.

Nga sa më sipër prej qytetarëve prioritet mbetet përmirësimi i infrastrukturës rrugore, infrastrukturës së institucioneve arsimore, sistemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, ndriçimi, shërbimi i pastrimit etj. Janë pikërisht këto prioritet të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit 2026 të cilin e paraqesim për miratim në këshillin e bashkisë. Veçanërisht rëndësi në këtë buxhet i është kushtuar rehabilitimit, sistemit dhe asfaltimit të rrugëve në blloqe sipas rajoneve për të cilat gjatë dëgjësive publike janë paraqitur kërkesa dhe vlera e tyre mund të përballohet nga ky buxhet pasi kostot e rehabilitimit sipas zonave nuk janë shumë të larta.

Ky dokument është hartuar prej grupit të punës të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 698, datë 09.12.2025 “ Për Ngritjen e Grupit të Punës Për Hartimin e Buxhetit të Vitit 2026 dhe Ndryshimeve të Mundshme në Paktën Fiskale” , i ndryshuar. Projekt Buxheti përmban të gjithë elementët e përcaktuar në ligjin 139/2015. Më specifikisht në nenin 41 “Buxheti Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe program buxhetor afatmesëm”, kërkohej që: Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore. Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:

1. Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh përfshirë edhe shlyerjen e borxhit të njësisë.
2. Të gjitha transfertat të parashikuara për tu marrë nga qeveria qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre.
3. Të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për tu siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë Bashkisë nga çfarëdo burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifat, vlerësimet, gjobot, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes.
4. Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse, parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:
 - 4.1 Qëllimin e investimit
 - 4.2 Planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit
 - 4.3 Shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret,
 - 4.4 Preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit.

Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Në zbatim të përmbushjes së detyrimeve ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj si dhe prioritetet e komunitetit është hartuar buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në vlerën **4,536,240 mijë lekë** nga të cilat 2,914,721 mijë lekë nga të ardhurat e veta ose 64.25%, Transferta e Pakushtëzuar 970,641 ose 21.40%, 651,078 mijë lekë Transferten Specifike ose 14.35%.

Buxheti sipas programeve buxhetore paraqitet si më poshtë:

Kapitulli	Emërtimi i Programit Buxhetor	Vlera në	% ndaj
		000 leke	buxhetit
1	Shërbime të përgjithshme Administrative dhe investime	1,735,451	38.25%
2	Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit	94,913	2.09%
3	Pyjet dhe kullotat	18,528	0.41%
4	Ujitja dhe Kullimi	50,883	1.12%
5	Shërbime publike	239,187	5.27%
6	Pastrimi ,Gjelberim	781,526	17.23%
7	Rrjeti rrugor	5,553	0.12%
8	Dekori	5,000	0.11%
9	Mirembajtja e Varrezave	52,375	1.15%
10	Menaxhimi i mbetjeve	141,390	3.12%
11	Ndriçimi i rrugëve	131,147	2.89%
12	Shërbimet kulturore dhe sportive	205,938	4.54%
13	Arsimi	856,327	18.88%
14	Kujdesi Social për të sëmurë dhe PAK	31,089	0.69%
15	Familje dhe fëmijët	70,573	1.56%
	Fondi Rezerve+fondi i mbrojtjes civile	116,560	2.57%
	Totali	4,536,440	100.00%

Ndërsa sipas klasifikimit ekonomik të llogarive buxhetore dhe përqindjes që secili zë shpenzimesh zë në totalin e shpenzimeve buxhetore për të ardhurat e veta për vitin 2026, treguesit jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela 2

Programi	Paga +Sig Shoq	Shpenz. Operative	Rezerve+ Emergjencia	investime	Te tjera	Totali
Totali	1,999,988	1,143,408	116,560	1,170,235	106,249	4,536,440

Objektivat e buxhetit të vitit 2026.

Objektivat e buxhetit të vitit 2026 janë te pandara me objektivat e buxhetit afatmesëm 2026-2028; ku prioritet e zhvillimit bazohen ne Planin e Përgjithshëm Vendor 2017-2030, si dokumenti bazë i cili është përgatitur me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, dhe është një mjet kyç i planifikimit të përdorur dhe do të formojnë të ardhmen e qytetit. Dokumenti ka identifikuar një seri prioritetesh kyçe ekonomike për bashkinë gjatë kësaj periudhe. Fokusi i Planit të Zhvillimit të Vlorës mund të përmbledhet në fushat e mëposhtme:

- Vazhdimi i përmirësimit të konkureshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik;
- Vazhdimi i zhvillimit të zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
- Vazhdimi i nxitjes së sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
- Vazhdimi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
- Përmirësimi i pastrimit të mjedisit në kuadrin e iniciativës së Qeverisë Shqipëtare për një Shqipëri të Pastër.

Si përfundim referuar kërkesave të përcjella prej strukturave përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve të bashkisë, prioriteteve të përcaktuara prej qytetarëve gjatë dëgjësive publike, dokumentave dhe prioriteteve afatgjatë dhe afatmesme të institucionit, objektivat e buxhetit për vitin 2026 janë si më poshtë vijon:

- Përmirësimi i Infrastrukturës urbane dhe rurale nëpërmjet projekteve zhvillimore në elementë të ndryshëm si rrugë, ndiçim, kanalizimet etj.
- Rikualifikimi i hapësirave publike, rehabilitim i sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese, shtimi i ambjenteve shplohëse dhe argëtuese.
- Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja sipas nevojave.
- Përmirësimi i shërbimit të pastrimit në qytet duke rikonceptuar, strukturuar dhe shpeshuar frekuencën e pastrimit të qytetit në zonat urbane dhe rurale.
- Përmirësimi cilësisë së jetës së shtresave në nevojë nëpërmjet programeve të ndryshme sociale;
- Rritja e vizibilitet të qytetit nëpërmjet mbështetjes së projekteve të brendshme dhe ndërkombëtare duke rritur imazhimin e qytetit dhe forcimin si një brend turistik në mesdhe dhe më gjerë.

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2026, përbën dokumentin financiar, i cili balancon të ardhurat dhe shpenzimet sipas programeve në vlerën 4,536,440 mijë lekë.

KAPITULLI II: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NË BUXHETIN E BASHKISË VLORE PËR VITIN 2026

Sipas nenit 34 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore,

donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësive vendore u garantohej me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2026 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vlore, nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë **4,536,440 mijë lekë**.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

1. Nga burimet e Buxhetit të Shtetit ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike për funksionet e bashkisë.
2. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe të ardhurat e tjera vendore).

NR.	EMERTIMI	Fakt 2023	Fakt 2024	I pritshmi 2025	Plan 2026
1	Te ardhurat nga taksat e tarifat te vitit korrent	1,090,867	2308.523		2,914,721
2	Te ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm	0	0		0
3	Transferta e pakushtëzuar	674,396	877.759	877.759	970,641
4	Transferta e pakushtëzuar nga viti i mëparshëm	0	0		0
5	Transferta specifike	447,453	582.812	582.812	651,078
6	Transferta specifike nga viti i mëparshëm	0		0	0
	T O T A L I	2,212,716	3769.094		4,536,440

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të Bashkisë Vlore me parashikim prej **2,914,721 mijë lekë**, dhe zënë 64.25% të totalit të të ardhurave.

Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e pakushtëzuar) prej **970,640 mijë lekë** zënë 21.40% të totalit të të ardhurave

Për vitin 2026 krahas transfertës së pakushtëzuar është akorduar edhe fondi transfertat specifike prej **651,079 mijë lekë** ose 14.35 % për funksionet e transferuara.

II.1. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore për vitin 2026 janë programuar në shumën **2,914,721 mijë lekë**.

Bashkia Vlore veprimtarinë fiskale e mbështet në këtë bazë ligjore:

- Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e

Shqiperisë" i ndryshuar

- Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, me ligjin 181/2013 dt. 28/12/2013, botuar në fletoren zyrtare nr.203, dt.30/12/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt.30/08/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore i Ndryshuar".
- V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024",

Bashkia Vlorë, garanton funksionin e saj, nëpërmjet taksave të parashikuara në ligj sipas akteve ligjore, ashtu edhe taksat e përkohshme dhe tarifave, të miratuara nga Keshilli i Bashkisë.

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.
2. Taksa e mjeteve të përdorura.
3. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
4. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesë + toke bujqësore).
5. Taksa e truallit.
6. Taksa e fjetjes në hotel.
7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksë parkimi.
10. Taksa mbi të ardhurat personale.
11. Tarifa për zënie e hapësirave publike.
12. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
13. Tarifa e shërbimit për subjektet me aktivitet ndërtimi.
14. Tarifa për shërbime të tjera nga pushteti vendor.
15. Tarifa për leje dhe çertifikata transporti.
16. Tarifa e shërbimit të ujitjes.
17. Të ardhura të tjera (nga qiratë, mjete, godine, tokë).
18. Të ardhura nga aplikim gjobash..
19. Të ardhura nga kopshte, çerdhe e shkolla.
20. Të ardhura nga institucionet vartësë.
21. Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuara.

Ky grup taksash dhe tarifash përbëhet nga:

1. Të ardhura tatimore
2. Të ardhura jo tatimore.

Paqyra përmbledhëse e të ardhurave për vitin 2026

Nr.	EMERTIMI	Plani 2024	Plani 2025	Plani 2026
1	Të ardhura nga taksat vendore	997,619	1,162,337	1,710,873
1.1	Të ardhura nga Agjentët Tatimor	113,500	126,500	164,000
1	Taksë për kalimin e së drejtës së pronësisë	23,000	30,000	65,000
2	Taksë e automjeteve të përdorura	87,800	92,500	97,200
3	Taksa e biznesit të vogël (Tatim i Thjeshtuar)	2,700	4,000	1,800
1.2	Taksë e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat+toka bujqësore)	884,119	1,035,837	1,546,873
1	Taksë ndërtese			254,586
1.1	Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesa qytetar	236,954	238,588	125,352
1.2	Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesa biznes			129,234
2	Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore	38,739	40,337	40,337
3	Taksë trualli	14,625	15,623	14,339

4	Taksë e fjetjes në hotel	27,224	47,220	86,352
5	Taksë e ndikimit në infrastrukturë (Drejtoria e	502,802	613,000	1,056,000
6	Taksë table + reklame	21,024	27,453	29,674
7	Taksë parkimi	5,177	6,706	7,110
8	Taksa mbi të ardhurat Personale	37,574	46,910	58,475
II	Të ardhurat nga tarifat vendore	495,389	268,383	538,040
1	Tarifë për zënien e hapësirave publike	150,250	135,261	116,261
1.1	Tarifë tregu	1,583	1,583	2,000
1.2	Tarifë e zënies së hapësirave publike	78,029	103,678	80,004
1.3	Tarifë e zënies së hapësirave publike plazh	70,638	30,000	34,257
2	Tarifë vjetore			421,779
2.1	Tarifë vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim qytetar	298,035	350,704	131,350
2.2	Tarifë vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjelbërim biznes	0	0	237,108
3	Tarifë shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi	26,915	27,000	29,792
5	Tarifë për shërbime të tjera nga pushteti vendor	5,033	80,294	1,200
6	Tarifë për leje dhe certifikata transporti	11,173	21,328	21,429
7	Tarifa e Ujitjes	3,983	4,500	900
III	Të ardhura të tjera	322,544	423,035	610,349
1	Të ardhura nga qirate (mjete+godine+toke)	41,325	39,727	39,727
2	Të ardhura nga Kontributi I subjekteve private në fondin publik të banesave sociale			170,759
3	Të ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë	258,946	358,283	371,338
4	Të ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat	22,273	25,025	28,525
IV	Të ardhura nga institucionet vartëse	77,720	104,064	55,459
4.1	Të ardhura nga teatri "Petro Marko"	790	964	1,080
4.2	Të ardhura nga Qendra Kulturore	1,875	1,950	2,300
4.3	Të ardhura nga Shumesportet	755	850	1200
4.4	Të ardhura nga ndërmarrja Shërbimeve Publike	1,000	10,000	12,729
4.5	Të ardhura nga pullat	300	300	300
	Projekte	73,000	90,000	37,850
5	Të ardhura të trashëguara	0	0	0
V	TOTALI I TË ARDHURAVE (Taksa-Tarifa)	1,893,272	1,957,819	2,914,721
1	transferta e pakushtëzuar	798,527	877,759	970,640
2	transferta e pakushtëzuar e trashëguar		0	
V	Total Transferta e pakushtëzuar	798,527	877,759	970,640
VI	Transferta e Pakushtëzuar + të Ardhurat e Veta	2,691,799	2,835,578	3,885,361
1	transferta e pakushtëzuar sektoriale	485,785	582,812	651,079
2	transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar			
VII	total transferta e pakushtëzuar sektoriale	485,785	582,812	651,079
	Buxheti I Përgjithshëm	3,177,584	3,418,390	4,536,440

Bazuar në VKB nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2024", të pritshmin e realizimit të buxhetit për vitin 2025, miratuar më V.K.B-në nr 111, datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025", të dhënat që disponon drejtoria në sistemin TAIS mbi: numrin e bizneseve aktiv që kanë ushtruar veprimtari tregëtare në territorin e bashkisë Vlorë; mbi pagesat e kryera nga bizneset përgjatë vitit 2025 për zërat e taksave dhe tarifave, ka planifikuar të ardhurat për projektbuxhetin e vitit 2026 për pjesën e të ardhurave që ndjek kjo drejtori, duke përfshirë edhe Agjentin Tatimor sh.a Ujësjellës Kanalizime i cili faturon dhe arkëton taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit për kategorinë familje, por edhe taksën e tokës bujqësore taksë e cila ndiqet nga Njësitë Administrative dhe punojësit e DTTV-së në cdo njësi.

Gjatë vitit fiskal 2025 Drejtoria e të Ardhurave Vendore sipas të dhënave të sistemit TAIS, në lidhje me numrin e subjekteve të regjistruara aktive, mbi të cilin janë llogaritur edhe planifikimi i të ardhurave për kategorinë "biznes", është si më poshtë:

Tabela 1

NR	Bashkia Vlore	Subjekte				Subjekte per planifikim
		2022	2023	2024	2025	2026
1	TP sh. pakice	2787	2161	2211	1949	2254
2	TP sh. shumice	43	39	41	38	82
3	TP sherbim	1454	2318	1910	2632	3267
4	TP p.lira	258	310	355	362	443
5	TP BM ad.kryesore	747	809	1460	2160	2197
6	TP BM ad.dytesore	355	278	557	0	0
7	T.P prodhim	198	229	234	252	312
8	OJF	38	46	46	58	58
9	Institucione Buxhetore			32	42	55
	TOTALI	5880	6190	6846	7493	8668


Sikurse vihet re nga viti 2025 për planifikimin e të ardhurave për vitin 2026 kemi një rritje me 15.7% të numrit të bizneseve, kjo bazuar në rrijen e numrit të subjekteve të regjistruar përgjatë vitit 2025.

Administrata tatimore e bashkisë për vitin 2026, do të aplikojë taksat dhe tarifat për subjektet e mëposhtme për çdo Rajon dhe Njësi Administrative:

Tabela 2

NR	Bashkia Vlore	Qyteti Vlore	Nj. A Orikum	Nj. A Novosele	Nj. A Shushice	Nj. A Qender	Totali
1	TP Tregeti	1951	209	75	21	80	2336
2	TP prodhim etj.	227	27	26	11	21	312
3	TP Sherbim	3140	66	25	8	28	3267
4	TP p.lira	436	4	3	0	0	443
5	TP BM ad.Kryesore	1754	248	82	15	98	2197
6	TP BM ad dytesore	0	0	0	0	0	0
7	OJF	58	3	0	0	3	64
8	T.P Inst.Buxhetore	40	3	2	3	1	49
	Total	7606	560	213	58	231	8668

Numri i njësive të biznesit sipas regjistrimit të adresës kryesore në Njesitë Administrative përkatëse.



1. Numri i subjekteve që ushtrojnë aktivitet tregtar, të ndarë sipas aktivitetit që kryejnë në Qytetin e Vlorës sipas rajoneve.

Tabela 3

NR	Bashkia Vlorë	Rajoni 1	Rajoni 2	Rajoni 3	Rajoni 4	Rajoni 5	Transport	Totali
1	TP Tregeti	129	475	702	295	350	0	1951
2	TP prodhim etj.	21	44	50	47	65	0	227
3	TP Sherbim	103	564	617	243	220	1393	3140
4	TP p. lira	118	120	135	31	32	0	436
5	TP BM ad.Kryesore	141	617	479	264	253	0	1754
6	TP BM ad dytesore	0	0	0	0	0	0	0
8	OJF	5	14	29	1	6	0	55
9	T.P Inst.Buxhetore	13	9	8	4	9	0	43
	Totali	530	1843	2020	885	935	1393	7606

TË ARDHURAT NGA TAKSAT VENDORE

1. Taksa mbi Pasurinë e Paluajtshme

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për cdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi. Ligji nr. 181, datë 28/12/2013 botuar në fletoren zyrtare nr.203, dt. 30/12/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt. 30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar".

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 106/2017 "Për disa Ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, ka pasur një seri me ndryshime në strukturën e të ardhurave nga taksa e pasurisë së paluajtshme.

Baza e taksës

Për kategorinë "biznes" janë të dhënat e subjekteve për taksen e ndërtesës, nën sipërfaqen e ndërtesës ku ushtrohet veprimtaria ekonomike.

Për kategorinë e Ndërtesave të Banimit informacioni sigurohet nga baza e të dhënave të Ndërmarrjes së Ujësjiellës Kanalizime, Gjendjes Civile dhe vetë deklarimit të familjarëve.

1.1 Takse Pasurie e Paluajtshme Ndërtesa

1.1.1 Kategoria e Familjarëve

Taksa e Pasurisë së Paluajtshme për këtë kategori është përlogaritur nga Agjenti Tatimor sh.a Ujësjiellës Kanalizime në bazë të numrit të familjeve që faturohen sipas kontratave të lidhura nga institucioni, ku kanë rezultuar për vitin 2025, **42,927** kontrata të lidhura.

Për vitin 2026 numri i familjeve që planifikohen për taksen e ndërtesës është **42,927** familje, bazuar në kontratat e lidhura tek agjenti tatimor, ku planifikimi për vitin 2026, sipas nivelit të taksës për çdo njësi administrative është sipas tabelës së mëposhtme:

Të ardhura nga faturimi dhe i pritshmi për taksen e pasurisë për vitin 2025 si dhe parashikimi për vitin 2026

Njësia administrative	Nr i kontratave të faturuara për vitin 2025	Niveli i taksës së ndërtesës në vit/familje miratuar me VKB	Faturimi i pritshëm 2025 në leke	Parashikimi faturimit për 2026 në leke	Parashikimi i nr të familjeve për vitin 2026
Vlorë	38289	258	9,878,562	9,878,562	38,289
Novoselë	1730	125	216,250	216,250	1,730
Shushicë	387	125	48,375	48,375	387
Qendër	745	125	93,125	93,125	745
Orikum fshat	1776	125/183	261,497	261,497	1,776
Orikum qytet					
Shuma	42,927		10,497,809	10,497,809	42,927

Në lidhje me taksen e ndërtesës për kategorinë familje vihet re se për planifikimin në buxhet për vitin 2026, është bërë një rishikim i këtyre taksave, pasi në bazë të të dhënave për tre vitet e fundit është parë se këto taksa nuk realizohen në raport me planifikimin vjetor. Për planifikimin e vitit 2026 janë marrë baza e të dhënave dërguara nga Agjenti Tatimor.

Bazuar në Ligjin Nr. 68/2017 “Për Financat E Vetëqeverisjes Vendore”, neni 5- Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore, në menaxhimin e financave vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin parimet e përcaktuara në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë dhe në këto parime, pika a)
- Në hartimin e buxhetit vjetor dhe të programit buxhetor afatmesëm njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohen në parashikime realiste të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të viteve të mëparshme, nisur nga të dhënat e mësipërme, për vitin 2026, duhet të planifikohen në buxhet taksat dhe tarifat të cilat janë të mundshme për tu mbledhur.

1.1.2 Kategoria e Ndërtesa të tjera (biznesi)

Sipas të dhënave të sistemit TAIS rezulton se për vitin 2025 janë të regjistruar për taksën e ndërtesës **5430 subjekte taksapaguese**, numër biznesesh të cilët së bashku me të pritshmin e vitit 2025, do të shërbejnë për planifikimin e buxhetit për vitin 2026.

- Vihet re se numri i subjekteve që paguajnë taksë ndërtese nuk përkon me numrin e subjekteve total për arsye se:
- 1393 subjekte me lloj aktiviteti transport të cilët nuk kanë ndërtesë ku ushtrojnë aktivitetin.
- Numri i lartë i subjekteve të cilët janë të llojit shërbim dhe adresë të biznesit kanë vendosur adresën e banesës së tyre.
- Disa subjekte të ndryshëm ushtrojnë aktivitet në të njëtin objekt siç janë profsionet e lira.

Të ardhurat e planifikuara për këtë kategori do të jenë në vlerën **129,234.5 mijë lekë** sipas koeficientit dhe vlerës për çdo njësi administrative:

Njësia		Vlore		Novoselë		Shushicë		Qëndër		Orikum Qytet		Orikum (Rurale)	
Cmimi referues per m2		61800		61800		61800		61800		60000		60000	
Shkalla e takses sipas VKM 132/2018		100%		65%		65%		65%		100%		67%	
Shkalla e takses sipas ligjit 68/2017		100%		70%		70%		70%		70%		70%	
Qellimi i perdorimit te pronës	Koeficient	M2	Vlcra	M2	Vlcra	M2	Vlcra	M2	Vlcra	M2	Vlcra	M2	Vlcra
njesi tregetimi dhe sherbimi	150%	185.4	522,356.5	84.36	33,552.0	84.36	3,567.60	84.36	35,747.0	126	36,208.6	84.42	104,730.9
Per parkim te mbuluar dhe bodrumet	70%	86.52	21,281.2	39.37	7,446.0	39.37	130	39.37	1,110.4	58.8	0.0	39.4	14,003.6
Per parkim te hapur	30%	37.08	440.0	16.87	2,671.9	16.87	40	16.87	6,457.5	25.2	0.0	16.88	0.0
Per veprimtari industriale	50%	61.8	122,096.4	28.12	45,821.6	28.12	720	28.12	14,163.0	42	1,531.8	28.14	14,003.6
Per veprimtari dhe hlegtori	30%	37.08	515.5	16.87	4,151.0	16.87	6,250.80	16.87	1,525.0	25.2	0.0	16.88	102.0
Total m2			666,689.7		93,642.5		10,708.40		59,002.9		37,740.4		132,840.1
Vlerësimi i taksës së ndërtesës sipas funksionit													
njesi tregetimi dhe sherbimi			96,844,904		2,830,447		300,963		3,015,617		4,562,284		8,841,383
Per parkim te mbuluar dhe bodrumet			1,841,253		293,149		5,118		43,716		0		551,741
Per parkim te hapur			16,315		45,075		675		108,938		0		0
Per veprimtari industriale			7,545,558		1,288,503		20,246		398,264		64,336		394,061
Per veprimtari dhe hlegtori			19,115		70,027		105,451		25,727		0		1,722
TOTALI		129,234,585.92	106,267,144.39		4,527,201.46		432,453.03		3,592,261.70		4,626,619.20		9,788,906.13

Element vlerësimi për taksën e ndërtesës është vlera 254,586mijë lekë si më poshtë:

Për kategorinë familje sipas të dhënave të Agjentit Tatimor **125,352 mijë lekë**

Për kategorinë biznes sipas të dhënave në sistemin TAIS në vlerën **129,234 mijë lekë**

Kategoria e Taksës mbi tokën bujqësore

Planifikimi i taksës së tokës bujqësore është bërë në bazë të informacionit të dhënë nga njësitë administrative sipas të dhënave që disponojnë nga regjistrat e DAMT-së.

Ekonomia		Kategoria	Lekë/ha në vit	Sip./ha	Vlefia
Bashkia Vlorë	Ish N.B Ullishte	VII	1800	340	612,000
	Ish N.B Rinia	III	3600	94	338,400
Totali B.Vlorë					950,400
Nj.A.Novoselë	Fitore	IV	3200	409	1,308,800
	Akërnj	VIII	1800	724	1,303,200
	Novoselë	V	3000	586	1,758,000
	Aliban	V	3000	300	900,000
	Mifol	V	3000	257	771,000
	Bishan	IV	3200	571	1,827,200
	Poro	V	3000	465	1,395,000
	Delisuf	VI	2400	370	888,000
	Dellenje	VI	2400	263	631,200
	Trevllazër	VI	2400	613	1,471,200
	Cerkovinë	VI	2400	217	520,800
	Skrofotinë	VI	2400	187	448,800
Totali Nj.A.Novoselë					13,223,200
Nj.A.Orikum	Dukat+Dukat Fushë	VI	1,197	2400	2,872,800
	Tragjas	VI	490	2400	1,176,000
	Orikum	III	363	3600	1,306,800
	Radhimë	III	357	3600	1,285,200
Totali Nj.A.Orikum					6,640,800
Nj.A.Qendër	Babicë e Madhe	VI	2400	682	1,636,800
	Babicë e Vogël	VI	2400	151	362,400
	Xhuherinë	VI	2400	194	465,600
	Kaninë	V	3000	699	2,097,000
	Kërkovë	VI	2400	275	660,000
	Zvërnec	VI	2400	241	578,400
	Sherishtë	V	3000	334	1,002,000
	Panaja	VI	2400	257	616,800
	Hoshtimë	VI	2400	354	849,600
	Nartë	VI	2400	634	1,521,600
	Bestrovë	VII	1800	349	628,200
Totali Nj.A.Qendër					10,418,400
Nj.A.Shushicë	Risili	IV	3200	471	1,507,200
	Bunavi	IV	3200	177	566,400
	Çepzat	IV	3200	214	684,800
	Llakatund	IV	3200	398	1,273,600
	Shushicë	IV	3200	360	1,152,000
	Grabian	IV	3200	232	742,400

	Drithas	IV	3200	352	1,126,400
	Mekat	IV	3200	421	1,347,200
	Beshisht	IV	3200	220	704,000
Totali Nj.A.Shushicë					9,104,000
TOTALI BASHKIA VLORE					40,336,800

Element vlerësimi për taksën e tokës bujqësore është vlera 40,337 mijë lekë.

2. Taksa mbi truallin

Llogaritja e kësaj takse për vitin 2025 është bërë mbi informacionin nga sistemi TAIS në lidhje me vlerësimin tatimor për zërin truall. Shuma e arketuar për vitin 2025 pritet të jetë në vlerën **14,339 mijë lekë**.

Nr.	Emertimi	Vlera e takses në lekë m2/vit për qellime banimi nga individët	Vlera e takses në lekë m2/vit për qellime biznesi
1	Takse trualli (lekë/m2)	0.56	20
2	Sipërfaqja (m2)	20,216.3	716,407.2
	Total (Lekë)	11,321.13	14,328,144
Shuma totale 1+2 (Lekë)			14,339,465.11

Siç vihet re kemi një rënie në planifikimin e taksës së truallit kjo për arsye se:

- Ndërtimet e reja që po zhvillohen në territorin e Bashkisë Vlorë ndikojnë në vlerësimin e taksës së truallit.
- Në zbatim të Vendim Nr.132/2018, trualli ku ndërtohen objektet përjashtohen nga taksa e pasurisë deri në momentin e përfundimit të ndërtimit.
- Element vlerësimi për planifikim është shuma **14,339 mijë lekë**.

3. Taksa e Fjetjes në Hotel

Në zbatim të Vendim Nr. 160, datë 12.03.2025 “Për Përcaktimin e Periudhës së Shfrytëzimit dhe të Nivelit Minimal të Kapacitetit të Shfrytëzimit të Strukturave Akomoduese”, ka ndryshuar mënyra e përlllogaritjes së taksës së hotelit për vitin 2025.

- Sipas pikës 6 të këtij vendimi, niveli minimal i shfrytëzimit të strukturës akomoduese është: a) jo më pak se 65 % e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën nga data 1 maj deri në datën 30 shtator; b) jo më pak se 30 % e kapacitetit të strukturës akomoduese për periudhën nga data 1 tetor deri në datën 30 prill. Kjo vlerë llogaritet si mesatare e nivelit minimal të shfrytëzimit përgjatë periudhës së shfrytëzimit.
- Sipas pikës 8 të këtij vendimi, Sipërmarrësit e strukturës akomoduese zgjedhin të deklarojnë nivelin e shfrytëzimit: sipas pikës 6 të këtij vendimi ose sipas parashikimeve të tyre.
- Për këtë arsye bazë për vlerësimin tatimor nuk është më numri i dhomave por kapaciteti i personave për dhomë.

Në total numri i dhomave sipas evidentimeve të bëra në terren, për vitin 2025 parashikohen 4692, me një kapacitet 11,993 persona.

- Çmimi i taksës së hotelit është:

- Hotel me 4-5 yje: 175 lekë për natë fjetje;
 - Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin: 70 leke per çdo nate fjetje për person.

Vlerësimi tatimor për subjektet të cilët kanë aktivitet hoteleri/turizëm parashikohet të jetë si me poshtë:

Nr.	Klasifikimi sipas takses se fjetjes ne hotel	Kapaciteti për dhomë(nr.persona për dhomë)	Koeficienti i shfrytëzimit	Ditë	Cmimi sipas VKB	Vlera (lekë)
1	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese për periudhën e parë maj-shtator	8,794	65%	153 dite/vit	70 lekë/ ditë	61,219,431
		221	65%	153 dite/vit	175 lekë/ ditë	3,846,228
		2,332	65%	45 dite/vit	70 lekë/ ditë	4,774,770
2	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese të cilët kanë bërë parashikimin sipas vendim nr.160/25 per periudhen maj-shtator	646	45%	153 dite/vit	70 lekë/ ditë	3,113,397
	Total periudha e parë maj-shtator	11,993				72,953,826
3	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese për periudhën e dytë tetor-prill	2,428	30%	212 dite/vit	70 lekë/ ditë	10,809,456
		221	30%	212 dite/vit	175 lekë/ ditë	2,459,730
4	Subjekte me veprimtari njesi akomoduese të cilët kanë bërë parashikimin sipas vendim nr.160/25	125	7%	212 dite/vit	70 lekë/ ditë	129,850
	Total periudha e dytë tetor-prill	2,774				13,399,036
5	Të ardhura totale (1+2+3+4)					86,352,862
	Vlera totale e takses se fjetjes ne hotel per vitin 2026					86,352,862

Element vlerësimi për planifikim është shuma 86,352 mijë lekë .

4. Taksë table dhe reklame

Duke u nisur nga regjistrimet në terren nga inspektorët, të dhënave të sistemit TAIS dhe nivelit të taksës sipas VKB Nr.96 date 07.12. 2023 “Per miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vlorë për vitin 2025”, planifikimi për vitin 2025 jepet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Lloji i tabelës	Nj/matese	Taksa	M2	Vlera
I.	Takse table per qellime identifikimi, te trupezuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe qe nuk perdoret per te reklamuar veprimtarite e te treteve (ku shenohet emri dhe/ose aktiviteti i biznesit)				
a	Deri ne 2 m2	Leke/m2/vit	0	0	0
	Mbi 2 m2 deri ne 10 m2				
b	E thjeshte (pa ndricim)	Leke/m2/vit	10000	386.3	3,863,000
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	15000	500.4	7,506,000
	Elektronike	Leke/m2/vit	20000	9.7	194,000
	Mbi 10m2 deri ne 20m2				
c	E thjeshte (pa ndricim)	Leke/m2/vit	8500	0	-
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	12750	10	127,500
	Elektronike	Leke/m2/vit	17000	0	-
	Mbi 20m2 deri ne 40m2				
ç	E thjeshte (pa ndricim)	Leke/m2/vit	5500	0	-
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	8250	3	24,750
	Elektronike	Leke/m2/vit	11000	0	-
	Mbi 40m2				
d	E thjeshte (pa ndricim)	Leke/m2/vit	4000	0	0
	Me ndricim te thjeshte	Leke/m2/vit	6000	0	0
	Elektronike	Leke/m2/vit	8000	0	0
II	Tabela per qellime identifikimi jashte territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit ne formen dhe permasat e tabelave per orientim				
	Tabele identifikuese		120	0	0
III	Tabele per qellime reklamimi e levizshme e palevizshme deri ne tavanin maksimal 35m2				
	E thjeshte	Leke/m2/vit	22500	680	15,300,000
	Elektronike	Leke/m2/vit	45000	57.77	2,599,650
IV	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, stenda, reklamuese, banderola, etj.				
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Leke/m2/dite	1,000	1	60,000
Totali					29,674,900

Element vleresimi per planifikim eshte shuma 29,674 mijë lekë .

II. TE ARDHURAT NGA TARIFAT VENDORE

Në këtë grup të ardhurash përfshihen të gjitha te ardhurat me natyrë jo tatimore, që rezultojnë nga ofrimi i shërbimeve publike, të drejtat e përdorimit të pronave publike dhe vendore dhe debia sipas subjekteve debitorë.

Më poshtë janë dhënë planifikimi sipas zërave të këtij grupi të ardhurash që ndjek Drejtoria e të Ardhurave Vendore.

1. Tarifa për zënien e hapësirave publike

Baza e tarifës për zënie të hapësirave publike është sipërfaqja në m², e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte apo individë (shitësit ambulantë) për qëllime biznesi. Tarifa llogaritet si detyrim mujor i taksapaguesit.

Tarifa për zënien e hapësirës publike përbëhet prej:

Nr	Emertimi	Tarifa leke/m ² ne muaj	Sipërfaqja në m ²	Totali
1	Per zenien e hapësirave publike ne Bulevardin Vlore Skele (duke përfshirë te dyja anet e tortuarit), pedonalia e sheshit Pavaresia Skele (ne te dyja anet)			
	Per përdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve te terrenit	500	772.7	4,293,000
	Per përdorimin e hapësirës publike per 12 muaj	400	1140.2	5,472,960
2	Per zenien e hapësirave publike ne zonen e Lungomares			
	Per përdorimin e hapësirës publike per 12 muaj	400	5571.7	26,744,160
	Per përdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve te terrenit	600	4143.7	12,179,340
3	Per zenien e hapësirave publike ne zonen e qendres Historike			
	Per përdorimin e hapësirës publike per 12 muaj	400	150	369,200
	Per përdorimin e hapësirës publike sipas akt kontrolleve te terrenit	300	1105.6	3,980,100
4	Per zenien e hapësirave publike në zonën e Plazhit të Vjetër dhe rruga Transballkanike të dy anët e saj (vija e parë e ndërtimit)	300	1810.5	6,518,010
5	Për zënien e hapësirës publike për zonat e tjera përveç pikës 1,2,34, përjashtimisht subjektet e pikës 7 të tabelës	200	9353	22,447,234
6	Subjekte ambulant në njësinë Vlorë	100	0	0
- Mbështetje logjistike për vendosjen e stendave, hapësirave ekspozuese dhe aktiviteteve të jashtme
- Shpenzime për dekorin, ambientimin, sigurinë dhe asistencën teknike gjatë eventeve

Pjesë e programit – Aktivitete të dedikuara për fëmijë

1. Lojëra dhe aktivitete – 500,000 ALL

Përshkrim

Ky zë përfshin organizimin e një sërë lojërash argëtuese, dinamike dhe edukative të dedikuara posaçërisht për fëmijët. Aktivitetet synojnë të krijojnë një ambient interaktiv dhe të sigurt, duke ofruar mundësi loje, zhvillimi motorik, kreativiteti dhe ndërveprimi social për fëmijët e grupmoshave të ndryshme.

Elementet që mbulon buxheti:

- Lojëra interaktive dhe sportive të përshtatura për fëmijë (gara, lojëra në grup, mini-aktivitete fizike)
- Pajisje të posaçme atraktive dhe të sigurta për organizimin e lojërave
- Staf facilituese, animatorë dhe kujdestarë të trajnuar për punë me fëmijë
- Koordinim dhe menaxhim i hapësirave të lojërave për garantimin e sigurisë dhe rendit

2. Zona për fëmijë – 500,000 ALL

Përshkrim

Zona për fëmijë do të krijojë një hapësirë të dedikuar me karakter edukativ, kreativ dhe argëtues, ku fëmijët do të mund të përfshihen në aktivitete artistike dhe lojëra të përshtatura për ta. Qëllimi është të ofrohet një eksperiencë cilësore për familjet dhe të mbështetet zhvillimi kreativ i fëmijëve në një mjedis të sigurt dhe mikpritës.

Elementet që mbulon buxheti:

- Kënd lojërash të përkohshme dhe pajisje argëtuese të përshtatura për moshat 3–12 vjeç
- Atelie kreative (pikturë, vizatim, modelim, punime artizanale)
- Animatorë, kujdestarë dhe staf i specializuar në aktivitete me fëmijë
- Elementë dekorativë tematikë, materiale sigurie dhe mirëmbajtje të zonës gjatë gjithë aktivitetit

STAFF	300,000
Akomodim, ushqim, transport	600,000
Marketing, printime, komunikim	1,000,000

Program artistik	3,700,000
Logjistik & produksion	
Stage, Lighting, LED, Audio, Tents, Chairs, Table	1,000,000
Skenografi	800,000
Decoration	1,000,000
Fireworks	500,000
	3,300,000
Albania open 2025	3,000,000
Paragliding suport	3,000,000
Triathlon	2,600,000
Suport per aktivitetin	2,600,000
Aktivitetet	
Lojra dhe aktivitete	500,000
Zona per femije	500,000
	500,000
	15,000,000

6- AULONA FOLK FESTIVAL

Periudha e Realizimit: Maj

Kosto Totale: 2 200 000

Ky festival ka për qëllim të promovojë trashëgiminë kulturore të Vlorës dhe tërheqjen e grupeve muzikore dhe artistëve të njohur të muzikës popullore. Eventi do të përfshijë koncerte, shfaqje dhe aktivitete kulturore, që do të mbështesin zhvillimin e artit dhe kulturës.

Ky festival është një mundësi për të promovuar trashëgiminë kulturore të Vlorës dhe tërheqjen e artistëve dhe grupeve muzikore popullore. Kostoja mbulon:

- Akomodim për artistët dhe grupet muzikore
- Shpenzimet për organizimin e shfaqjeve dhe performancave të drejtpërdrejta
- Kostoja e logistikës dhe transportit për pjesëmarrësit
- Marketing dhe mbulimi i ngjarjes në mediat sociale dhe përmes kanaleve tradicionale.

7- TURNEU NDËRKOMBËTAR I BEACH TENIS – QERSHOR 2025

Kategoria: Turizëm Natyror & Sportiv

Kosto Totale: 20,000,000 ALL

Përshkrimi i Aktivitetit

Turneu Ndërkombëtar i Beach Tennis, i planifikuar të zhvillohet në Qershor 2025, përfaqëson një nga ngjarjet më të rëndësishme sportive të sezonit veror, duke sjellë në Vlorë sportistë elitare dhe ekipe ndërkombëtare nga vende të ndryshme të botës. Ky event synon të promovojë qytetin si një destinacion të klasit të lartë për sportet bregdetare, duke e kombinuar turizmin natyror me aktivitetet

sportive profesionale në një ambient unik bregdetar.

Duke shfrytëzuar vijën bregdetare të Vlorës, turneu do ta shndërrojë zonën e plazhit në një hapësirë sportive ndërkombëtare, ku do të zhvillohen ndeshje profesionale, aktivitete argëtuese dhe demonstrime sportive që tërheqin turistë, vizitorë dhe komunitetin lokal.

Objektivat kryesore

- Promovimi i Vlorës si një destinacion ndërkombëtar për sportet e plazhit dhe turizmin aktiv
- Rritja e vizibilitetit ndërkombëtar të qytetit përmes pjesëmarrjes së sportistëve dhe mediave sportive
- Nxitja e ekonomisë lokale nëpërmjet rritjes së fluksit të turistëve dhe pjesëmarrësve
- Përfshirja e komunitetit në një event sportiv, argëtues dhe edukues të standardeve të larta

Kostoja mbulon:

- Organizimin profesional të turneut (fusha, pajisje sportive, infrastrukturë bregdetare)
- Siguri teknike dhe staf ndërkombëtar të certifikuar
- Vendosjen e tribunave, zonave VIP, hapësirave publike dhe shërbimeve mbështetëse
- Promovim dhe marketing në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar
- Akomodim, transport dhe asistencë për sportistët dhe ekipet pjesëmarrëse
- Aktivitete shoqëruese, program festues dhe logjistikë të përgjithshme të eventit

Shënim

Në vijim të këtij buxheti do të jetë bashkëngjitur informacioni i detajuar mbi aktivitetin, përfshirë programin, preventivin teknik dhe specifikimet organizative.

8- 1 QERSHORI 2026

Emri i aktivitetit: Festimet e Ditës së Fëmijëve

Data e aktivitetit: 1 Qershor 2026

Periudha e realizimit: Qershor 2026

Lloji i aktivitetit: Kulturorë/Turistike – Edukative dhe Argëtuese

Kosto totale e parashikuar: 1,000,000 Lekë

Qëllimi i aktivitetit:

Organizimi i një eventi festiv dhe edukativ për fëmijët, që përfshin animacione, lojëra, dhe aktivitete argëtuese, me synimin për të nxitur pjesëmarrjen aktive të fëmijëve dhe familjeve, promovimin e kulturës dhe edukimin përmes lojës dhe artit.

Përshkrimi i aktiviteteve:

- Animacione dhe shfaqje artistike: Klovne, magjistarë, teatër kukullash dhe aktivitete interaktive që zhvillojnë imagjinatën e fëmijëve.
- Lojëra dhe gara sportive: Lojëra ekipore, gara me pengesa dhe aktivitete që nxisin bashkëpunimin dhe lojën kolektive.
- Punëtori edukative: Stacione kreative për vizatim, pikturë, krijim manual dhe aktivitete edukative të përshtatura për fëmijët e moshave të ndryshme.
- Shërbime logjistike: Sigurimi i hapësirës, skenës, pajisjeve audio-dhe-dritës, dekorimeve të ambientit dhe sigurisë gjatë aktivitetit.

- Promovim dhe ftesa publike: Reklamim online dhe në media lokale, shpërndarje ftesash dhe njoftime për tërheqjen e pjesëmarrësve.

Nr.	Lloji i shpenzimit	Çmimi në Lekë	TOTAL (me TVSH)
1	Materiale për punët dhe lojëra	350,000	350,000
2	Shërbime teknike (scenë, zë, dritë)	300,000	300,000
3	Dekorime dhe hapësirë aktivitete	200,000	200,000
4	Promovim dhe reklamim	150,000	150,000

Shuma totale e parashikuar: 1,000,000 Lekë

9- AKTIVITETI “MARATONA E KËNGËS POPULLORE”

Data e aktivitetit: Korrik/Gusht 2026 (data specifike sipas programit)

Periudha e realizimit: Korrik/Gusht 2026

Lloji i aktivitetit: Kulturor / Muzikor / Traditash Popullore

Organizuesi: Klan TV

Kosto totale e parashikuar: 1,200,000 Lekë

Qëllimi i aktivitetit:

Ky aktivitet ka për qëllim promovimin dhe zhvillimin e muzikës dhe traditave popullore shqiptare, duke nxitur pjesëmarrjen e komunitetit dhe mbështetur artistët lokalë.

Përshkrimi i aktiviteteve:

- Shfaqje muzikore: Performanca të këngëtarëve popullore dhe grupeve folklorike, duke pasuruar programin me elemente artistike tradicionale.
- Skena dhe pajisje teknike: Sigurimi i skenës, fonisë, mikrofonëve dhe pajisjeve audio-dhe-dritës për realizimin e shfaqjeve muzikore.
- Mbështetje logjistike: Organizimi i hapësirës për publikun, koordinimi i stafit teknik dhe i sigurisë gjatë eventit.
- Promovim dhe informim publik: Reklamim në media lokale dhe online për tërheqjen e pjesëmarrësve dhe promovimin e traditave popullore.

Ky aktivitet mbështet zhvillimin e muzikës dhe traditave popullore. Kostoja mbulon shfaqjet muzikore, skenën, foninë dhe mbështetjen logjistike për organizimin.

10- AKTIVITETI “VERË DHE PORTOKALLE”

Data e aktivitetit: Korrik/ Gusht2026 (data specifike sipas programit)

Periudha e realizimit Korrik/ Gusht 2026

Lloji i aktivitetit: Kulturor/Turistike / Event Mediatik

Organizuesit: Top Channel & Spektakli Portokalli

Kosto totale e parashikuar: 1,000,000 Lekë

Qëllimi i aktivitetit:

Ky aktivitet ka për qëllim promovimin e turizmit dhe kulturës lokale përmes një eventit mediatik dhe festiv, që kombinon muzikën, shfaqjet artistike dhe aktivitetet argëtuese për publikun.

Përshkrimi i aktiviteteve:

- Shfaqje live dhe spektakle televizive: Performanca artistike e Spektaklit Portokalli, aktivitete interaktive dhe humoristike për të gjitha moshat.
- Promovim i verës dhe produkteve lokale: Prezantime të verërave dhe produkteve të zonës, degustime të shëndetshme dhe edukative për pjesëmarrësit.
- Dekorime dhe ambient festiv: Sigurimi i skenës, dekorimeve tematike dhe hapësirave për publikun dhe median.
- Shërbime teknike: Pajisje audio, dritë, kamera dhe logjistikë për realizimin e eventit live.
- Promovim dhe ftesa publike: Reklamim në mediat lokale dhe online, koordinim me rrjetet e Top Channel.
- Organizimi i aktivitetit: Top Channel dhe Spektakli Portokalli
- Mbështetja logjistike dhe teknike: Bashkia Vlorë

Shuma totale e parashikuar: 1,000,000 Lekë

11- FESTIVAL VEROR 2025 – KONCERT I MADH DANSMUSIK FEST

Periudha e Realizimit: Gusht 2025

Kosto Totale: 5,000,000 lekë

Ky festival do të përfshijë aktivitete për të gjithë familjen, shfaqje artistike, muzikore dhe kulturore. Ky aktivitet është një ngjarje kulmore verore, që do të përfshijë një gamë të gjerë aktivitets muzikore, artistike dhe argëtuese, duke ofruar mundësi për të gjithë vizitorët dhe qytetarët të bashkohen për të festuar sezonin veror në qytetin e Vlorës.

Përshkrimi i Detajuar:

Festival Veror 2025 do të kulmojë me një koncert të madh veror, ku do të performojnë DJ ose këngëtarë të njohur kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ky koncert është projektuar për të tërhequr një audiencë të gjerë dhe për të krijuar një përvojë muzikore të paharrueshme për qytetarët dhe vizitorët.

Elementet kryesore të koncertit:

- Skenë e madhe dhe teknologji moderne (tingull, drita, monitorim video).
- Koncerte live nga këngëtarë të njohur
- Siguri dhe logjistikë profesionale për pjesëmarrësit.
- Promovim intensiv në media dhe rrjete sociale.

12- FESTIVALI "MARE MEUM" – AKTIVITET KULTURORE/TURISTIKE

Festivali "Mare Meum" – Muzikë Klasike

Periudha e Realizimit: 4 netë, Gusht–Shtator 2025

Kosto Totale: 1,200,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Festivali "Mare Meum" është një ngjarje kulturore dhe turistike e fokusuar te muzika klasike. Për katër netë radhazi, publiku do të ketë mundësinë të dëgjojë performanca të instrumentistëve të njohur shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Festivali synon të promovojë artin klasik dhe të rrisë prestigjin kulturor të qytetit të Vlorës si destinacion turistik dhe muzikor.

Elementet Kryesore të Festivalit:

- 4 netë koncerti me program të larmishëm klasik.
- Performanca nga instrumentistë të njohur shqiptarë dhe artistë ndërkombëtarë.
- Skenë dhe pajisje teknike të avancuara për tingull dhe drita.
- Promovim në media dhe rrjete sociale për të tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj.
- Siguri dhe logjistikë profesionale për pjesëmarrësit dhe artistët.

Nr.	Lloji i Shpenzimit	Sasia/Detaje	Çmimi në Lekë	Total (Lekë)
1	Artistë dhe Instrumentistë	6–8 instrumentistë të njohur shqiptarë dhe të huaj	600,000	600,000
2	Skena dhe Teknikë	Skena, tingull, drita, monitorim	300,000	300,000
3	Promovim dhe Marketing	Reklama, postera, social media	150,000	150,000
4	Siguri dhe Logjistikë	Sigurim, roje, emergjenca	100,000	100,000
5	Rezerva dhe Papritura	Shpenzime të paparashikuara	50,000	50,000

Total: 1,200,000 Lekë

13- TETORI ROZË – KULTURORE/EDUKATIVE

Periudha e Realizimit: Tetor 2025

Kosto Totale: 500,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

“Tetori Rozë” është një aktivitet kulturor dhe edukativ i fokusuar në ndërgjegjësimin e grave për rëndësinë e kontrollave mjekësore dhe parandalimit të sëmundjeve, duke përfshirë:

- Ligjërata dhe prezantime nga specialistë shëndetësorë (doktorë, nutricionistë, psikologë).
- Materiale informative mbi shëndetin e vajzave dhe grave.
- Prodhim i një video ndërgjegjësuere, e cila do të shpërndahet online dhe në media për të arritur një audiencë më të gjerë.
- Promovim në rrjete sociale dhe media lokale për të maksimizuar ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen.

Ky aktivitet synon të rrisë informimin dhe ndërgjegjësimin e grave, duke kontribuar në një komunitet më të shëndetshëm dhe të edukuar.

14- AKTIVITETI: “MUAJI I LETËRSISË” – KULTURORE/EDUKATIVE

Periudha e Realizimit: Tetor 2025

Kosto Totale: 500,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

“Muaji i Letërsisë” është një aktivitet kulturor dhe edukativ që synon të promovojë letërsinë dhe

kulturën letrare në komunitet. Aktiviteti do të përfshijë:

- Lexime publike dhe prezantime të veprave letrare nga autorë të njohur shqiptarë.
- Diskutime mbi letërsinë për të rinjtë dhe të apasionuarit pas shkrimit.
- Ekspozita të librave, botimeve të reja dhe materialeve edukative letrare.
- Promovim dhe shpërndarje e informacionit përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

Ky aktivitet synon të rrisë interesin për letërsinë, të promovojë autorët shqiptarë dhe të krijojë mundësi për edukim kulturor dhe artistik.

15 - AKTIVITETI: “15 TETORI – ÇLIRIMI I VLORES” – KULTURORE/TURISTIKE

Periudha e realizimit: 15 Tetor 2025

Kosto Totale: 700,000 Lekë

Vendndodhja: Sheshi kryesor i qytetit dhe zona historike e Vlorës

Përshkrimi i aktivitetit

Ky aktivitet ka për qëllim të kujtojë Çlirimin e Vlorës duke krijuar një atmosferë festive, kulturore dhe edukative për qytetarët, vizitorët dhe komunitetin shkollor. Për herë të parë, përveç shfaqjeve artistike dhe performancave muzikore, aktiviteti do të përfshijë edhe pjesëmarrjen e fëmijëve dhe shkollave përmes lojërave edukative, aktiviteteve kreative dhe ekspozitave të punimeve artistike të nxënësve.

Elementet kryesore të aktivitetit:

- Shfaqje artistike dhe muzikore që lidhen me historinë dhe kulturën e qytetit.
- Ekspozita fotografike dhe dokumentare mbi historikun e Çlirimit të Vlorës.
- Aktivitetet edukative dhe kreative për fëmijët dhe shkollat (punëtori arti, vizatime, lojëra tematike historike).
- Promovim kulturor dhe turistik për të tërhequr vizitorë dhe për të rritur ndërgjegjësimin historik.

Ky aktivitet ka si qëllim forcimin e identitetit dhe krenarisë qytetare, duke kombinuar edukimin historik me promovimin kulturor dhe pjesëmarrjen aktive të komunitetit shkollor dhe familjar.

Preventivi i aktiviteteve (Total: 700,000 Lekë)

Nr.	Lloji i shpenzimit	Sasia/Detaje	Çmimi (Lekë)	Totali (Lekë)
1	Artistë dhe performanca	Shfaqje muzikore dhe artistike	250,000	250,000
2	Teknikë dhe skenografi	Skena, tingull, drita, materiale	200,000	200,000
3	Promovim dhe marketing	Postera, social media, media lokale	100,000	100,000
4	Aktivitetet për fëmijë dhe shkolla	Lojëra edukative, ateliers arti, ekspozita nxënësish	100,000	100,000

5	Siguri dhe logjistikë	Roje, emergjenca, pastrim	50,000	50,000
---	-----------------------	---------------------------	--------	--------

Total: 700,000 Lekë

16- “FESTIMET E 28–29 NËNTORIT” – KULTURORE/TURISTIKE

Periudha e Realizimit: 28–29 Nëntor 2025

Kosto Totale: 3,500,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Festimet e 28–29 Nëntorit janë një ngjarje kulmore që shënon Ditën e Pavarësisë dhe Ditën e Flamurit, duke përfshirë aktivitete kulturore, turistike dhe artistike për qytetarët dhe vizitorët. Festimet synojnë të promovojnë historinë, kulturën dhe identitetin kombëtar, duke krijuar një atmosferë festive dhe argëtuese për të gjithë pjesëmarrësit.

Elementet Kryesore të Festimeve:

- Parada dhe evente artistike, duke përfshirë shfaqje teatrale, performanca tradicionale dhe aktivitetet e komunitetit.
- Koncerti i Madh Festiv: Performanca nga këngëtarë të njohur shqiptarë dhe ndërkombëtarë, me skenë të madhe, teknologji të avancuar për tingull dhe drita, promovim dhe menaxhim të plotë logjistik.
- Ekspozita dhe aktivitete turistike, përfshirë promovimin e traditave, kulturës dhe produkteve kulturore të zonës.
- Zona argëtuese për vizitorët dhe promovim i turizmit lokal.
- Promovim intensiv në media dhe rrjete sociale për të tërhequr vizitorë vendas dhe të huaj.
- Siguri dhe logjistikë profesionale për pjesëmarrësit dhe artistët.

Nr.	Lloji i Shpenzimit	Sasia/Detaje	Çmimi në Lekë	Total (Lekë)
1	Artistë Kryesorë / Koncerti i Madh	këngëtarë të njohur për koncertin festiv	1,800,000	1,800,000
2	Skena dhe Teknikë	Skena, tingull, drita, monitorim video	1,200,000	1,200,000
3	Promovim dhe Marketing	Postera, social media, media lokale	300,000	300,000
4	Siguri dhe Logjistikë	Roje, emergjenca, pastrim	150,000	150,000
5	Rezerva dhe Papritura	Shpenzime të paparashikuara	50,000	50,000

Total: 3,500,000 Lekë

17- AKTIVITETI: “CHRISTMAS MARKET & FESTIMET PËR FESTAT E VITIT TË RI”

– KULTURORE/TURISTIKE

Periudha e Realizimit: Dhjetor 2025

Kosto Totale: 4,500,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet është i fokusuar në krijimin e një zone festive të Christmas Market, që synon të ofrojë një përvojë unike dhe argëtuese për qytetarët dhe vizitorët:

- Elementet Kryesore të Christmas Market:
- Stenda të dekoruara festive:
- Shitje të produkteve artizanale, dhuratave, produkteve tradicionale dhe suvenireve festive.
- Stenda tematike me drita dhe dekoracione që krijojnë atmosferë festive.
- Zona për argëtim dhe aktivitete për vizitorët:
- Piste për fotot festive dhe dekorime interaktive.
- Aktiviteti për fëmijë dhe familje (përfshirë animacione dhe punëtori të vogla).
- Performanca dhe Koncertet festive:
- Koncerte të shkurtër nga artistë lokalë dhe muzikë live për të krijuar atmosferë festive.
- Mundësi për të prezantuar edhe grupe folklorike dhe instrumentistë të njohur.
- Dekoracione dhe instalime të veçanta:
- Pema e madhe e Vitit të Ri dhe drita festive në zonën e sheshit.
- Elemente të dritshme dhe të ndriçuara që tërheqin vizitorët.
- Promovim dhe Marketing:
- Postera, social media dhe media lokale për të tërhequr qytetarë dhe turistë.
- Fushata për të promovuar produktet e artizanëve dhe stendat festive.
- Siguri dhe Menaxhim Logjistik:
- Roje dhe shërbime emergjente për pjesëmarrësit.
- Menaxhim i rregullt i rrugëve dhe aksesit për vizitorët dhe furnizuesit.

18- AKTIVITETI: “FESTIME PËR VITIN E RI” – KULTURORE/TURISTIKE

Periudha e Realizimit: Dhjetor 2025, me ngjarje kulmore natën e 31 Dhjetorit

Kosto Totale: 5,500,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të krijojë një atmosferë festive dhe të paharrueshme për qytetarët dhe vizitorët, duke përfshirë:

Elementet Kryesore:

1. Ceremonia e ndezjes së dritave festive
 - Vendosja e pemës së Vitit të Ri dhe ndezja e dritave në shesh.
 - Pjesëmarrja e autoriteteve dhe qytetarëve për të hapur sezonin festiv.
2. Koncert festiv natën e 31 Dhjetorit
 - Performanca nga 5 këngëtarë të njohur shqiptarë dhe ndërkombëtarë.
 - Skenë e madhe me teknologji për tingull, drita dhe monitorim video.
 - Ambient i organizuar me siguri dhe logjistikë profesionale për pjesëmarrësit.
3. Zonë festive dhe aktivitete argëtuese
 - Stenda festive, atraksione, pika për foto dhe aktivitete interaktive për vizitorët.
 - Eksperiencë për të gjitha moshat për të përjetuar atmosferën e festave të fundvitit.
4. Promovim dhe Marketing

- Postera, social media, media lokale dhe reklama për të tërhequr vizitorë vendas dhe turistë.
- 5. Siguri dhe Logjistikë
 - Roje, emergjenca, pastrim dhe menaxhim të rrugëve dhe aksesit për vizitorët dhe artistët.

19- AKTIVITETI: “NJË VAKT I NGROHTË PËR NJERËZIT NË NEVOJË DHE FËMIJËT JETIM” – Kulture/Turistike

Periudha e Realizimit: Dhjetor 2025

Kosto Totale: 1,000,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të ofrojë ndihmë dhe ngrohtësi për njerëzit në nevojë dhe fëmijët jetim, duke kombinuar elemente kulturore dhe turistike për të krijuar një atmosferë festive dhe solidariteti.

Elementet Kryesore të Aktivitetit:

1. Shpërndarja e vakteve të ngrohta për familjet në nevojë dhe fëmijët jetim.
2. Organizimi i një zone festive për eventin, me dekorime dhe muzikë të lehtë festive për të krijuar atmosferë të ngrohtë dhe të ftuar.
3. Promovim i vlerave humanitare dhe kulturës së bashkëpunimit mes qytetarëve dhe komunitetit lokal.
4. Koordinim me institucionet sociale dhe bamirësit lokalë për sigurimin e ushqimeve dhe menaxhimin e logjistikës.
5. Siguri dhe menaxhim logjistik për shpërndarjen e ushqimeve dhe për pjesëmarrësit.

Nr.	Lloji i Shpenzimit	Sasia/Detaje	Çmimi në Lekë	Total (Lekë)	Shënime
1	Ushqime dhe Pije	Vakti i ngrohtë për rreth 500 persona	600,000	600,000	Përbërësit dhe gatimi i vakteve
2	Dekoracione dhe Ambient Festiv	Zona festive me drita dhe dekor	150,000	150,000	Dekorime për të krijuar atmosferë festive
3	Promovim dhe Marketing	Poster, fletushka, social media	100,000	100,000	Informimi i qytetarëve dhe komunitetit
4	Logjistikë dhe Siguri	Transport, organizim, roje	100,000	100,000	Siguria dhe shpërndarja e ushqimeve
5	Rezerva dhe Papritura	Shpenzime të paparashikuara	50,000	50,000	Për menaxhimin e çdo shpenzimi të paparashikuar

Total: 1,000,000 Lekë

20- AKTIVITETI: “FESTA TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË VLORE” – KULTURORE/TURISTIKE

Periudha e Realizimit: E gjithë viti 2025

Kosto Totale: 2,000,000 Lekë

Vendndodhja: Njësitë administrative të Vlorës

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të promovojë traditat lokale, kulturën dhe turizmin në njësitë administrative të qytetit të Vlorës, përmes:

- Organizimit të panairove dhe festave lokale ku prezantohen produkte artizanale, gastronomi, art dhe kulturë të zonës.
- Koncerteve dhe shfaqjeve artistike me artistë lokalë dhe muzikë tradicionale.
- Aktiviteteve argëtuese për vizitorët, duke përfshirë lojëra dhe punëtori kreative për fëmijë dhe të rinj.
- Promovimit të turizmit lokal, duke ofruar informacion mbi atraksionet dhe historinë e secilës njësie administrative.
- Bashkëpunimit me komunitetin dhe autoritetet lokale, për organizimin dhe menaxhimin e aktiviteteve.
- Promovim dhe Marketing, për të tërhequr vizitorë vendas dhe turistë.

21- Panairo të Ndryshme – Artizanat & Gastronomi

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Kosto Totale: 5,000,000 Lekë

Ky program përfshin disa panairo të organizuara gjatë vitit në qytete bregdetare si Vlora, Durrësi dhe Saranda, me fokus në artizanatin lokal, gastronominë tradicionale dhe promovimin e turizmit. Qëllimi është të ofrohet një eksperiencë gjithëpërfshirëse për vizitorët, duke mbështetur bizneset lokale dhe rritur njohuritë për kulturën gastronomike dhe artizanatin.

1. Panairi i Artizanatit

Vendndodhja: Qendrat historike dhe sheshet kryesore të qyteteve bregdetare

Përshkrim:

Ky panair promovon produktet artizanale të rajonit, duke përfshirë punime druri, tekstile, qeramikë dhe produkte tradicionale të kulturës vendase. Vizitorët kanë mundësinë të njohin mjeshtrat lokalë dhe të blejnë produkte unike.

Aktivitete kryesore:

- Stenda me artizanat lokalë
- Demonstrime të teknikave tradicionale të prodhimit
- Punëtori kreative për fëmijë dhe shkolla
- Performanca artistike dhe muzikore

2. Panairi i Gastronomisë Detare

Vendndodhja: Plazhet dhe sheshet e qyteteve bregdetare

Përshkrim:

Ky panair fokusohet në kuzhinën tradicionale detare të Adriatikut dhe Jonit, duke bashkëpunuar me restorantet dhe operatorët gastronomikë të qyteteve bregdetare. Qëllimi është promovimi i gastronomisë lokale dhe krijimi i mundësive për zhvillim biznesi.

Aktivitete kryesore:

- Stenda me produkte të peshkut dhe gatime tradicionale
- Konkurse gatimi dhe demonstrime kulinare
- Shfaqje kulturore dhe performanca muzikore

- Lojëra dhe aktivitete edukative për fëmijë dhe shkolla

3. Panairi Kombëtar i Turizmit dhe Traditës (opsional)

Vendndodhja: Sheshi kryesor i qytetit të Vlorës

Përshkrim:

Ky panair mbledh operatorë turistikë, agjenci udhëtimi dhe komunitete lokale për të promovuar turizmin, kulturën dhe traditat e zonës. Ai shërben si një platformë për bashkëpunim midis sektorit publik dhe privat.

Aktivitete kryesore:

- Stenda promovuese për turizmin dhe artizanatin
- Ekspozita fotografike dhe dokumentare për traditat lokale
- Aktivitetet interaktive për fëmijë dhe nxënës të shkollave
- Program kulturor dhe performanca artistike

Kostoja mbulon:

- Organizimin dhe vendosjen e stendave për të gjitha panairot
- Marketing dhe promovim kombëtar dhe ndërkombëtar
- Aktivitetet shoqëruese (shfaqje, konkurse, demonstrime kulinarie dhe artizanale)
- Logjistikë, dekorime dhe mbështetje operative për pjesëmarrësit dhe vizitorët

22- AKTIVITETI: “PROMOVIM & MARKETING I QYTETIT TË VLORËS”

Periudha e Realizimit: Gjatë gjithë vitit

Kosto Totale: 4,000,000 Lekë

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të promovojë qytetin e Vlorës si destinacion turistik dhe kulturor, duke përdorur mjete tradicionale dhe dixhitale, dhe duke përfshirë:

Elementet Kryesore të Promovimit dhe Marketingut:

1. Video Promocionale
 - Realizimi i video-ve për të promovuar atraksionet turistike, aktivitetet kulturore dhe ngjarjet e qytetit.
 - Përhapje në kanale televizive dhe platforma online.
2. Fushata Media
 - Postime në rrjetet sociale, reklama online dhe media lokale.
 - Krijimi i përmbajtjeve interaktive dhe inovative për të tërhequr turistë dhe vizitorë.
3. Guida Turistike dhe Materiale Promovuese
 - Prodhimi dhe shpërndarja e broshurave, fletëpalosjeve, guideve informuese dhe banerave për të prezantuar atraksionet, aktivitetet dhe ngjarjet e qytetit.
 - Materialet do të jenë të dizajnuara për të tërhequr vizitorë dhe për të përmirësuar imazhin e qytetit.
4. Platforma Dixhitale
 - Zhvillimi ose përmirësimi i faqes dhe aplikacionit të qytetit, për informacion të lehtë mbi ngjarjet, atraksionet dhe ofertat turistike.
5. Branding Qytetar
 - Elemente vizuale dhe identitet për qytetin: logo, banera dhe materiale promovuese

për qytetarët dhe vizitorët.

23- AKTIVITETI: “START-UP – TRAJNIME PËR GUIDA, OPERATORË TURISTIKE, PRITJE & SHËRBIM, STANDARDIZIM PRODUKTESH”

Projekte me operatorë të ndryshëm – Bashkëpunime ndërinstitucionale & rajonale – Edukim, Certifikim & Inovacion

Periudha e realizimit: Gjatë gjithë viti

Kosto Totale: 4,400,000 Lekë

Përshkrimi i aktivitetit

Ky aktivitet synon të rrisë profesionalizmin e stafit turistik, të standardizojë produktet turistike të qytetit të Vlorës dhe të forcojë bashkëpunimin midis aktorëve të ndryshëm të turizmit dhe kulturës, duke përfshirë edhe ide inovative dhe projekte Start-Up. Aktiviteti realizohet në bashkëpunim me universitete, institucione arsimore dhe operatorë të certifikuar, duke përfshirë projekte pilot, trajnime dhe certifikime për operatorë të rinj dhe të inovativë.

Qëllimi kryesor është të promovohet turizmi i qëndrueshëm dhe inovativ, të rritet cilësia e shërbimeve dhe të krijohen mundësi për startup-e dhe projekte të përbashkëta me aktorë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Elementet kryesore të aktivitetit

1. Trajnime për guida turistike

- Përmirësimi i njohurive mbi historinë, kulturën dhe atraksionet e qytetit.
- Praktika për menaxhimin e vizitorëve dhe komunikimin efektiv me turistët.
- Fokus në start-up-et turistike dhe inovacionin në udhëzime dhe eksperiencën vizitorësh.

2. Trajnime për operatorë turistike

- Menaxhimi i shërbimeve turistike dhe organizimi i tureve.
- Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe të standardizuara për turistët.
- Inkurajimi i projekteve Start-Up dhe ideve inovative për zhvillimin e shërbimeve turistike.

3. Trajnime për pritje dhe shërbim

- Standardet e mikpritjes, etiketa dhe sjellja profesionale ndaj turistëve.
- Fokus në cilësinë e shërbimit dhe përvojën e vizitorit.

4. Standardizimi i produkteve turistike

- Trajnime dhe certifikim për prodhimet artizanale, gastronomike dhe suvenire turistike.
- Sigurimi i cilësisë dhe promovimi i produkteve të certifikuara.

5. Certifikim dhe vlerësim

- Dhënia e certifikatave për pjesëmarrësit që përfundojnë trajnimet.
- Monitorim i vazhdueshëm i standardeve dhe përmirësimi i shërbimeve turistike.

6. Bashkëpunim me operatorë lokalë dhe rajonalë

- Organizimi i projekteve të përbashkëta, tureve turistike, eventeve kulturore dhe projekteve Start-Up.
- Përforsimi i rrjetit të operatorëve për të rritur vizibilitetin dhe cilësinë e shërbimeve.

7. Bashkëpunime ndërinstitucionale

- Partneritete me bashki, institucione kulturore, qendra arsimore dhe organizata turistike.
- Koordinim për aktivitete dhe projekte të përbashkëta që lidhen me promovimin e turizmit, kulturës dhe inovacionit.

8. Projekte rajonale dhe ndërkombëtare

- Bashkëpunime me aktorë rajonalë dhe ndërkombëtarë për zhvillimin e turizmit dhe promovimin e qytetit të Vlorës.
- Realizimi i projekteve të përbashkëta për shkëmbimin e përvojave, praktikave më të mira dhe ideve Start-Up.

9. Promovim i rezultateve

- Publikimi dhe promovimi i projekteve të realizuara në media, rrjete sociale dhe kanale institucionale.
- Përforsimi i imazhit të qytetit si destinacion turistik cilësor, inovativ dhe mikpritës për startup-e dhe ide të reja.

24- AKTIVITETI: “KONFERENCA, SIMPOZIUME DHE EVENTE PËR DITËT E RËNDËSISHME” – Kulture/Edukative

Periudha e Realizimit: Gjatë gjithë vitit

Kosto Totale: 1,500,000 Lekë

Përshkrimi i aktivitetit

Ky aktivitet ka për qëllim të promovojë dhe shënojë ditët e rëndësishme historike, kulturore dhe ndërkombëtare, duke zhvilluar një sërë ngjarjesh që nxisin edukimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e komunitetit lokal dhe vizitorëve.

Aktiviteti përfshin:

- Konferenca dhe simpoziume për trajtimin e temave historike, kulturore dhe edukative.
- Ligjërata dhe panele diskutimi me ekspertë, studiues dhe përfaqësues institucionale.
- Ekspozita dhe workshop-e që lidhen me trashëgiminë kulturore, turizmin dhe zhvillimin lokal.
- Evente edukative dhe interaktive për qytetarët, nxënësit dhe studentët.

Qëllimi kryesor është të forcohet njohja historike, promovimi i kulturës dhe edukimi qytetar, duke përfshirë temat e ditëve ndërkombëtare dhe kombëtare me rëndësi për qytetin dhe rajonin

Ditë e Rëndësishme dhe Eventet e Përkatëse:

Data	Ngjarja / Dita e Rëndësishme	Lloji i Eventit
20 Shkurt	Përmbysja e bustit të diktatorit (1991)	Konferencë / Simpozium
5 Maj	Dita e Dëshmorëve të Atdheut	Konferencë / Ceremoni përkujtimore
9 Maj	Dita e Evropës	Ligjërata / Panel diskutimi
5 Shtator	Nënë Tereza (shpallja shenjtore, 2016 – përkujtohet zyrtarisht)	Simpozium / Ekspozitë

29 Shtator	Dita Botërore e Turizmit & Dita e Trashëgimisë Kulturore	Panel / Ekspozitë / Workshop
1 Tetor	Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve	Ligjërata / Event edukativ
22 Nëntor	Kongresi i Manastirit – Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe (1908)	Simpozium / Ekspozitë historike
8 Dhjetor	Dita e Rinisë (lëvizja studentore e 1990)	Panel / Event edukativ
10 Dhjetor	Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut	Konferencë / Workshop / Diskutim

25 “PJESËMARRJA NË PANAIRE” – PROMOVIM & MARKETING

Periudha e Realizimit: Gjatë gjithë vitit

Kosto Totale: 4,000,000 Lekë

Vendndodhja: Panairot në Tiranë, Bari, Berlin, Prishtinë, etj.

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të promovojë qytetin e Vlorës dhe ofertat e tij turistike, kulturore dhe artizanale në panairot rajonale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë:

Elementet Kryesore:

1. Panairot Turistike dhe Kulturore
 - Organizimi i stendave të qytetit të Vlorës në panairot të njohura si Tirana, Bari, Berlin dhe Prishtina.
 - Prezantimi i atraksioneve turistike, ngjarjeve kulturore dhe produkteve artizanale lokale.
2. Materiale Promovuese dhe Branding
 - Broshura, fletëpalosje, guide turistike dhe banera për secilën pjesëmarrje.
 - Elemente vizuale që promovojnë identitetin e qytetit.
3. Aktiviteti në Panairot
 - Organizimi i prezantimeve, degustimeve të produkteve lokale, performancave artistike dhe shfaqjeve të vogla kulturore.
 - Interaksion me operatorë turistikë, vizitorë dhe media për të rritur vizibilitetin e qytetit.
4. Promovim dhe Media
 - Informim i medias lokale dhe ndërkombëtare për pjesëmarrjen dhe aktivitetet e qytetit.
 - Përdorimi i rrjeteve sociale dhe platformave online për të pasqyruar pjesëmarrjen.

26- AKTIVITETI: “EVENTE EMERGJENTE DHE INICIATIVA PILOT” – REZERVË PËR AKTIVITETET E REJA

Periudha e Realizimit: Gjatë gjithë vitit

Kosto Totale: 4,000,000 Lekë

Vendndodhja: Qyteti i Vlorës dhe njësitë administrative sipas nevojës

Përshkrimi i Detajuar:

Ky aktivitet ka për qëllim të sigurojë fleksibilitet dhe mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve të paplanifikuara, pilot projekteve dhe eventeve emergjente, duke përfshirë:

Elementet Kryesore:

1. Evente Emergjente
 - Aktivitetet që lindin si nevoja gjatë vitit, për shembull përkujtime, aktivitete kulturore, promovime ose ngjarje speciale që nuk ishin planifikuar paraprakisht.
2. Iniciativa Pilot
 - Projekte eksperimentale ose inovative për turizmin, kulturën ose edukimin që mund të testohen përpara zhvillimit të mëtejshëm.
3. Fleksibilitet i Buxhetit
 - Përdorimi i kësaj rezerve mundëson reagim të shpejtë ndaj mundësive të reja dhe sfidave që mund të shfaqen gjatë vitit.
4. Mbështetje për Organizatorët Lokalë
 - Financim i aktiviteteve të organizuara nga komunitetet, njësitë administrative ose organizata joqeveritare që kontribuojnë në zhvillimin kulturor dhe turistik.

Per vleresim buxheti projekte 90,000 mije leke

8.Shpenzimet e Keshillit Bashkiak

1. Shpenzime operative

NR.	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	VLERA VJETORE
1	Botime periodike(raporti vjetor i veprimtarisë së këshillit, Gazeta juridike e Këshillit, fletëpalosje)	130,000
2	Përmbledhje e vendimeve të Këshillit 2025	150,000
3	Blerje karta urimi për ftesat zyrtare	25,000
4	Dërgim me postë i dokumenteve, shkresave të Këshillit dhe Këshilltarëve	12,000
5	Kancelari për zyrë	200,000
6	Shpenzime udhëtimi	500,000
7	Shpenzime për Aleancën e Grave Këshilltare	500,000
9	Vizita studimore të Këshilltarëve	2,500,000
10	Trajnime për Këshilltarët	500,000
11	Shpenzime për pritje/përcjellje	300,000
12	Shpenzime për mbledhjet e Këshillit	100,000
14	Flamuri Kombetar, Flamuri i Bashkisë për sallën e Këshillit,	150,000

	dhe Logo e Bashkisë(x3)	
15	Shpenzime për shërbime financiare	1,000,000
16	Shpenzime operative të paparishikuara	300,000
SHUMA TOTALE		6,367,000

2. Investime

NR.	EMËRTIMI I SHPENZIMEVE	VLERA VJETORE
1	Printer (2 copë)	600,000
2	Mikrofona (bashkëlidhur preventive)	2,200,000
	SHUMA	2,800,000

Element vleresimi per buxhetin 9,167 mije lek

9. Shpenzime per ASHK**12,000 mije lek**

Shenim: Për sa i përket zërit investime ne shumen prej 2,800,000 leke per Keshillin Bashkiak si dhe Investimi per rikonstruksionin e banesave te shtresave ne nevojë ne shumen prej 16,000,000 lek eshte perfshire ne listen e investimeve te bashkise Vlore .

Tabele përmbledhëse e shpenzimeve

Nr.	Emërtimi	Vlera
1	Shpenzime për paga	504,703
2	Shpenzime per sigurime shoqërore	81,680
3	Shpenzime Operative	221,355
5	Shpenzime për transferta tek Këshilli i Qarkut	29,147
6	Shpenzime për familjet ne nevojë	3,500
7	Shpenzime per bonus strehimi	10,500
7	Shpenzime për aktivitete kulturore-artistike-sportive-sociale-turizmi	90,000
8	Shpenzime për Dekorin e Festave te Fund Vitit	15,000
9	Shpenzimet për Këshillin Bashkiak	6,367
10	SHpenzime per ASHK	12,000
	Totali	974,252

f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon
Gjate gjithë vitit.

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e
projektit: Bashkia Vlore

NORMATIVAT E DISA SHPENZIMEVE

Shpenzime për qira godinash

Nr.	Emërtimi	Njësia	Tarifa mujorë
1	Zyrat e Rajonit Nr. 1	000/lekë	deri 70
2	Zyrat e Ndihmës sociale	000/lekë	deri 30
3	Qira godine, zyra Aleat tek Conad	000/lekë	deri 60

Normativat e Konsumi te Karburantit

Nr.	Emërtimi	Njësia	tarifa mujore
1	Autovetura Hyndai policia bashkiake Naftë	litra	deri 200
2	Autovetura Hyndai policia bashkiake Benzine	litra	deri 200
3	Autovetura Hyndai Inspektoriat ndertimor Naftë	litra	deri 200
4	Autovetura Hyndai Inspektoriat ndertimor Benzine	litra	deri 200
5	Autovetura Hyndai Drejtoria e Tatimeve naftë	litra	deri 200
6	Autovetura benc Administrata naftë	litra	deri 600
7	Motokarro Njesia Administrative Novosel Naftë	litra	deri 100
8	Autoveture Ford Njesia Administrative Novosel Naftë	litra	deri 250
9	Autoveture Seat Njesia Administrative Shushice	litra	deri 250
10	Eskavator Fiat Njesia Administrative Novosel Naftë	litra	deri 300
12	Autoveture Skoda Njesia Administrative Orikum Naftë	litra	deri 200
13	Mjet me qera per Administraten	litra	deri 350
14	Autoveture Ford Njesia Administrative Qender Benzine	litra	deri 200
14	Autoveture Hyndaj Fuoristrad Njesia Administrative Qender Naftë	litra	deri 250
15	Korrse bari Njesite Administrative benzine	Litra	deri 50
16	Gjenerator Njesia Orikum naftë	Litra	deri 100

REPETITORET (PERFORCUESIT)

Nr. 2	Projekti: Repetitorët Kodi:III.2.2	Lloji i programit: K04980. Shërbime Publike
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
Bashkia Vlorë për shpenzimet për repetitorët është mbështetur ne V.K.M Nr. 123, date 26.02.1996, “Për një ndryshim ne V.K.M Nr. 315, date 11.07.1994 Për ruajtjen e përsëritësve televizive”. Për vitin 2024 për këtë shërbim shpenzimet planifikohen ne vlërën 96 mije lekë .		
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.

Pasqyra përmbledhëse e treguesve financiarë të shërbimit të dekorit

Nr.3	Projekti : Shërbimi Dekorit dhe Mirëmbajtjes se Varrezave Publike dhe të Dëshmorëve. Kodi: III.2.3	Llojet e programit K01320: Shërbimet Publike Funksioni : Dekori i mjediseve publike dhe mirëmbajtja e sinjalistikës, Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimi publik të varrimit;
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		

Për vitin 2026 Bashkia Vlore do të vijojë shërbimet për mirëmbajtjen e

- Edhe për "SHERBIMI I DEKORIT" për vitin 2026 do të realizohet e njëjta procedure.

Dekori i mjediseve publike dhe mirëmbajtja e sinjalistikës realizohet nga Buxheti i Bashkisë, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Drejtorisë e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve. Në strukturën e Drejtorisë është një specialist për dekorin e një specialist për sinjalistikën që punojnë me kohë të plotë për realizimin e shërbimit dhe specialistet e ndriçimit që punojnë me kohë të plote për dekorin në rastet e festave. Gjithashtu me kohë të pjesshme për dekorimin e mjediseve vihen në dispozicion edhe 2 autovinçat e ndriçimit në varësi të Drejtorisë e Infrastrukturës dhe Zbatimit të Projekteve.

Puna që kryhet:

Ky shërbim realizohet kryesisht për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, në rastet e festave të tjera zyrtare si dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë vitit. Sipërfaqja e shesheve dhe e rrugëve të dekoruara në territorin e Bashkisë është rritur progresivisht nga viti në vit. Pjesa më e madhe e dekorit realizohet me elementë të investuar në vite, të cilët ruhen dhe mirëmbahen nga punonjësit e sektorit. Çdo vit programohen fonde modeste me të cilat realizohet blerja e elementëve të rinj për dekorimin e shesheve kryesore dhe akset kryesore në qendër të qytetit.

II. Synimi i projektit

Të përmirësohet cilësia e jetës së qytetarëve

Përmirësimi i dekorit urban në të gjithë territorin e Bashkisë së Vlorës.

Përmirësimi i dekorit për aktivitete dhe krijimi i një atmosfere gjatë festimeve

Të rritet cilësia e ofrit të shërbimit të varrezave

Rritja e performancës së shërbimit të mirëmbajtjes sipas rregullores së funksionimit.

Shërbim dhe komunikim normal me qytetarët

Ruajtja dhe administrim i këtyre ambienteve sipas ligjit.

b) Rezultatet e pritshme

Krijimi i dekorit në të gjithë sheshet dhe rrugët kryesore në zonat urbane;

Krijimi i dekorit festiv me rastin e festave zyrtare dhe të fundvitit;

Administrim sipas standardeve duke realizuar rrethimin e territorit.

Funksionim sipas rregullores me orare të përcaktuara.

Plotësimi i parcelave të reja me bordure të gjelberata,

Mbjellja e pemëve dekorative

Gadishmëria për të shërbyer në çdo moment për kryerje të shërbimit funeral

Organizim i ambienteve të varrezave sipas standardeve dhe rregullores

Për vlerësim buxheti 5,000 mijë leke.

c) Aktoret e mundshëm

Operatori që kryen këtë shërbim për qytetin.

Grupi i punës që do kryejë monitorimin e shërbimit të dekorit.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Buxheti i Bashkisë

e) Shpenzimet e llogaritura

Pasqyra përmbledhëse e treguesve financiarë të shërbimit të pastrimit

Nr.4 a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

Në Njësinë Administrative Orikum shërbimi i pastrimit kryhet nga të tretët dhe kontrata e shërbimit është një vjecare.

Për këtë arsye nuk parashikohet ndryshim i fondit financiar në buxhetin e vitit 2026, fond i cili është parashikuar sipas analizës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimeve	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
1	Ngarkim, transport mbeturina	3 650 t/vit	3,347.58 leke/ton	12,218,667	12 muaj
2	Fshirje e rrugëve dhe shesheve				
2.1	a.Fshirje me mjet teknologjik	21 344 952 m2/vit	0.361 leke/m2	7,705,398	12 muaj
2.2	b. Fshirje me fshese	9 020 688 m2/vit	0.73 leke/m2	6,585,102	12 muaj
3	Larje rrugëve me ujë				
3.1	Sherbimi i larjes me ujë te shesheve	3 684 840 m2	0.2 leke/m2	736,968	12 muaj
4	Sistemim mbeturina	3 650 t/vit	182 lek/t	664,300	12 muaj
Çmimi Neto për 1 vit		27,910,435			
TVSH (%) për 1 vit		5,582,087			
Çmimi Total për 1 vit		33,492,522			

II. Synimi i projektit

Rritja e performancës së shërbimit të pastrimit.

Rritja e numrit të banoreve që përfitojnë këtë shërbim duke e shtrirë këtë në të gjithë zonat që është e mundur nga ana infrastrukturës rrugore.

Plotësimi me kazanë metalike për grumbullim in e mbeturinave urbane.

Grafik i përmirësuar i shërbimit për mënyrën dhe kohen e nxjerrjes dhe evadimit te mbeturinave urbane duke synuar diferencimin mbetjeve ne burim.

Nxitjen e interesit për biznesin për fillimin e aktivitetit te riciklimit te mbetjeve urbane

b) Rezultatet e pritshme

Për shërbimin e pastrimit te qytetit.

Shërbim me parametra dhe sipas standardeve për te gjithë territorin.

Shtimi i pikave te vendeve te grumbullimit te mbeturina për ti shërbyer me mire familjarit me rritjen e numrit te kazanëve.

Eliminimi i pikave te rrezikshme te vend-depozitimeve, duke ndërtuar xhepat ne trotuare.

Kryerjen e këtyre shërbimeve sipas grafikeve dhe frekuencave te përcaktuara nga investitori.

Fillimi i diferencimit te mbetjeve urbane qe ne burim dhe grumbullimi tyre ne orare te përcaktuar sipas një grafiku paraprak.

Fillimi i interesimit nga biznesi për procesin e riciklimit.

Për shërbimin e Pastrimit ne Njësite Administrative.

Kryerja e shërbimit te grumbullim transportit te mbeturinave ne te njëjtat standarde si ne qytet.

Kazanë metalike ne pikat e grumbullimit te mbeturina duke rritur rendimentin e punës, duke eliminuar problemet mjedisore si dhe shërbim me standarde.

Rritja e numrit te përfitueseve te shërbimit ne pjesën me te madhe te njësite administrative.

<

Babice e Vogel	- 8,0 km
Kerkove	- 11,0 km
Xhyherine	- 8,0 km
Sherishte	- 8,6 km
Kanine	- 5,0 km
Zvernec	- 7,5 km
Narte	- 6,3 km

Sipërfaqe që fshihen janë 55,000 m² (sipas planimetrive dhe tabelave përkatëse)

2 PASTRIMI URBAN NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUSHICË

Heqja dhe transporti i mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar, cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Punëtorët e pastrimit kanë për detyrë të heqin mbeturinat e lokaleve dhe familjeve që ndodhen në fshatrat e Njesisë Administrative Shushicë. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina do të kryhet transporti i tyre në pikën e hedhjes së mbeturinave të caktuar. Pastrimi dhe transporti i mbeturinave do të bëhet cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Pikat e grumbullimit në Njësine Administrative Shushicë:

1	Fshati Risili	km	7.1	8 pika
2	Fshati Çeprat	km	9.5	2 pika
3	Fshati Bunavi	km	11.8	2 pika
4	Fshati Grabian	km	12.5	3 pika
5	Fshati Llakatund	km	13.5	8 pika
6	Fshati Shushice	km	13.5	7 pika
7	Fshati Mekat	km	15.5	3 pika
8	Fshati Drithas	km	18	6 pika
9	Fshati Beshisht	km	20	pika

Sipërfaqe që fshihen janë 3200 m² vetëm në qendër të Njesisë Administrative

5. PASTRIMI URBAN NJËSIA ADMINISTRATIVE NOVOSELË

Heqja dhe transporti i mbeturinave urbane në vendin e hedhjes së caktuar, cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Punëtorët e pastrimit kanë për detyrë të heqin mbeturinat e lokaleve dhe familjeve që ndodhen në fshatrat e Njesisë Administrative Novoselë. Pas ngarkimit të mbeturinave në makina do të kryhet transporti i tyre në pikën e hedhjes së mbeturinave të caktuar. Pastrimi dhe transporti i mbeturinave do të bëhet cdo 3 ditë në javë, ose 10 herë në muaj.

Njesia Administrative Novosele ka te instaluara ne total 43 konteniere dhe 53 pika te tjera ne hapësirën e 12 fshatrave, perkatesisht:

Fshati Novosele	km	20	11 pika
Fshati Dellenje	km	34	6 pika
Fshati Delisuf	km	32	8 pika
Fshati Bishan	km	24	10 pika
Fshati Poro	km	31	7 pika
Fshati Fitore	km	22	11 pika

Fshati Mifol	km	16	6 pika
Fshati Akerni	km	13	8 pika
Fshati Aliban	km	17	7 pika
Fshati Skrofotine	km	15	6 pika
Fshati Cerkovine	km	12	6 pika
Fshati Trevllazer	km	7	Pika

Sipërfaqe që fshihen janë 254,000 m²

Ne fshatin Novosele 18,000m².

Ne fshatin Bishan 8,000m².

Ne fshatin Fitore 16,000 m².

Ne fshatin Poro 6,400 m².

Ne fshatin Delisuf 5,600 m².

Ne fshatra të tjerë sipas nevojave 200,000 m² (Dellenje + Mifol + Aliban + Akerni + Cerkovine + Skrofotine + Trevllazer).

Bazuar në shërbimet e përcaktuara në kontratë Administratorët e Njësi Administrative përfituese Novoselë, Qendër, Shushicë, Bashkia Vlorë, do të kryejnë kontrollin dhe realizimin e kontratës për territorin e tyre, të cilët do të raportojnë me shkrim në Drejtorinë e Investimeve, Strehimit dhe Transportit (Drejtoria e Shërbimeve). Drejtoria pasi mbledh raportimet mujore nga cdo Njësi Administrative mbi shërbimet e realizuara në territorin e tyre, harton situacionin mujor i cili nënshkruhet prej Drejtorit, Kryetarit të Bashkisë dhe Kontraktorit.

e) Shpenzimet e llogaritura

Kontrata Oriku			33,493
Pastrim Njësi Administrative			37,762
		Totali	71,255

Për vlerësim buxheti 2026 – 71,255 mijë leke

f) Periudha e zbatimit (kur fillon, kur përfundon)

Gjate gjithë vitit 2026

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Shërbimet Publike nëpërmjet mbikëqyrësve të kontratave.

Nr.5	Projekti : Menaxhimi i integruar i mbetjeve (trajtimi i mbetjeve të ngurta) Kodi: III.2.5	Llojet e programit: K05100 – Menaxhimi i mbetjeve Funksioni: Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane
------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

Në bazë të VKB nr. 36, date 28.03.2019 është ngritur dhe ka filluar funksionimin Ndërmarrja për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane në Bashkinë e Vlorës.

Objektivi i Përgjithshëm i Programit është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta (MMN), në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve dhe standardeve shqiptare të harmonizuara me standardet mjedisore të BE-së. Projekti

mbështetet nga ana financiare edhe nga Banka Gjermane KfW, ku pjesë e investimit janë vend depozitimi sanitar, një impiant për ndarjen e mbetjeve dhe një njësi kompostimi, që do të bëhen plotësisht funksionale në vendin e caktuar në Sherishtë. Qendra e Manaxhimit të Mbetjeve ka një kapacitet përpunimi prej rreth 1.2 milion ton mbetje.

Pas marrjes në dorëzim të impiantit nga Bashkia Vlorë, Ndërmarrja MIM Vlora do të fillojë aktivitetin normal me objektiv depozitim të mbetjeve urbane, klasifikimin e mbetjeve të riciklueshme dhe kompostimin e mbetjeve organike, por dhe sensibilizimin e qytetarëve.

- funksionimin efektiv dhe efikas të këtyre objekteve sipas ligjeve dhe njohurive bashkëkohore;
- monitorimin dhe kontrollin mbi pranimin e mbetjeve, mbajtjen e të dhënave nga peshorja e landfillit, dhe menaxhimin e performancës së ofrimit të shërbimeve sipas planeve operacionale;
- analiza të rregullta mbi sasinë e mbetjeve dhe standardet e cilësisë, dendësinë dhe balancën e vëllimeve të mbetjeve rajonale;
- trajnimi efektiv dhe kualifikimi i stafit të përfshirë në ofrimin e shërbimeve;
- mbështetje në programet e ndërgjegjësimit publik dhe proceset e komunikimit për çështjet mjedisore dhe reduktimin e mbetjeve.

ii. Synimi i projektit

Ndërmarrja do të trajtojë dhe përpunojë mbetjet bashkiake të cilat përfshijnë mbetjet shtëpiake, mbetjet jo të rrezikshme tregtare, industriale dhe institucionale të cilat grumbullohen brenda skemave të mbledhjes së menaxhimit të mbetjeve bashkiake, sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare për trajtimin e mbetjeve dhe ruajtjen e mjedisit.

b) Rezultatet e pritshme

1. Përfundimi i ndërtimit të Landfillit të Sherishtës vitin 2026.
2. 100% e mbetjeve të grumbulluara do të trajtohen në landfill
3. 36.1% e mbetjeve të riciklueshme do të ndahen në impiantin e riciklimit
4. Ndërgjegjësim i komunitetit për ndarjen në burim

c) Aktoret e mundshme

Ndërmarrja e Menaxhimit të Mbetjeve

d) Kontributet e mundshme në projekt

Buxheti i Bashkisë dhe KfW

e) Shpenzimet e llogaritura

Pozicioni	Nr	Paga e grupit	Shtesa për pozicion	Vjetërsi	Shtesa punë të vështira të dëmshme për shëndetin	Total Paga Vjetore	Sigurime vjetore
Drejtori II-2	1	141,000	14,000	24%	4,000	2,314,080	386,451
Përgjegjës III-3	4	98,000	14,000	24%	4,000	6,696,960	1,118,392
Specialist IV-2	2	80,000	14,000	24%	4,000	2,812,800	469,738
Specialist IV-3	4	70,000	14,000	24%	4,000	5,030,400	840,077
Specialist IV-4	1	60,000	14,000	24%	4,000	1,108,800	185,170
MB	27		51,000	1%	4,000		

						21,951,000	3,665,817
Totali Pagave	39					39,914,040	6,665,645
Orët Shtesë, Turnet						1,930,000	322,310
Fondi Vecantë						500,000	
Totali fondi Pagave (600)						42,344,040	
Sigurime (601)						6,987,955	
Total						49,331,995	

I. Shpenzime Operative dhe Mirëmbajtje 602

Nr.	Shpenzimet sipas qendrave të kostos (Lek)	Totali
1	Administrimi i përgjithshëm dhe kontroll standartizim dhe sigurie	
	Energji elektrike	950,000
	Internet Telefon IT	120,000
	Hostim, mirëmbajtje faqe interneti	120,000
	Siguracion mjetesh	3,000,000
	Kancelari dhe bojëra printeri	300,000
	Kronika televizive	120,000
	Shpenzime për mjete promociionale	240,000
	Produkte pastrimi	120,000
	Pajime të Mbrojtjes Personale	1,700,000
	Dezinsektim, Dezinsektim dhe Deratim	1,200,000
	Shpenzime mjek pune	720,000
	Shërbim postar, tarife vjetore leje mjedisore, Taksa mjetesh, Shpenzime komision angazhimi, Shërbim Bankar etj	400,000
	Aktivitete marrëdhënie me publikun	210,000
7	Shpenzime peshqirë, çarçaf futa, te tjera	600
8	Te tjera te pa parashikuar	1.000
9	Lyerje	1.500
	SHUMA	9.620

Emërtimi	Planifikuar mijëra leke
Paga	19.378
Sig.Shoqerore	3.141
Shpenzime operative	9.620
Totali	32.139

Për vlerësim buxheti 2026 – 32.139 mijë lekë

f) Periudha e zbatimit

1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026

g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:

Zyra e financës, drejtori.

Qendra për Shërbime Komunitare

Nr.	Projekti: Qendra për Shërbime Komunitare Kodi:III.19.2	Lloji i programit: K10430 - Familja dhe fëmijët Funksioni: Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		

I. Situata

Qendra për shërbime Komunitare është strukturë e ngritur në kuadër të projektit “Shërbime Komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuar” nga shoqata “Ndihmoni Jetën” dhe Save the Children për një periudhë tre-vjeçare dhe pas kësaj periudhe qendra ka kaluar në administrimin e Bashkisë Vlorë si një nga bashkëpunuesit e projektit.

Qendra komunitare i ofron shërbimet e veta në ambientet e Çerdhes Nr:2, Rr: Enver Jaho, ambient i ofruar nga Bashkia Vlorë.

Qendra ofron shërbime nga një ekip multidisiplinar për fëmijë me aftësi të kufizuar, me synimin gjithëpërfshirjen e tyre në kopshte, shkolla dhe komunitet. Ky ekip përbehet nga: menaxherja e qendrës, psikolog, punonjës social, edukator, terapist të foluri dhe terapist okupacional.

Grupet e synuara:

Fëmijët nga moshë 2.5-21 vjeç dhe familjet e tyre.

II. Synimi i projektit

Shërbimet e ofruara:

Vlerësime dhe ngritje e programeve edukativ individual për fëmijët e shkollave dhe kopshteve.

Terapi individuale dhe ne grup për fëmijët me AK ne fushat e zhvillimit, ne fushën e konjicionit, të moterikes fine e globale, në fushën e komunikimit dhe autonomise personale. Disa nga programet janë në: modifikimin e sjelljes, të art terapisë dhe lojës. Fëmijët ndiqen me metodën Portage (shërbim në familje) dhe Heart-terapi.

Mbështetje dhe ngritjen e kapaciteteve të prindërve për të advokuar dhe lobuar për të drejtat e fëmijëve të tyre.

Ndërgjegjësimi i komunitetit për të mbështetur gjithë përfshirjen e fëmijëve ne fusha të caktuara të jetës.

Informimi dhe promovimi i shërbimeve:

Kontrata e lidhur që në fillimet e funksionimit të qendrës midis familjes së fëmijëve me AK dhe Qendrës Komunitare.

Informacioni që marrin prindërit në mënyrë periodike nga stafi qendrës dhe fletëpalosjet e përgatitur me informacion të ndryshëm që ndihmojnë prindërit në rritjen e kapaciteteve të tyre.

Statistikat e qendrës:

Që nga fillimi i projektit e deri në Dhjetor 2019 qendra ka ofruar dhe ofron shërbime për 83 fëmijë dhe 3 të rritur (40 F dhe 46 M), të grupmoshës 2.5-21 vjeç.

6 është numri i fëmijëve që frekuentojnë qendren çdo ditë nga ora 9-13.

12 është numri i fëmijëve që marrin shërbim në familje nga terapistet e qendrës.

68 është numri i fëmijëve të kopshteve dhe shkollave që marrin shërbim në qendër.

III. Aktivitetet kryesore të projektit

Arritjet:

Fëmijet kanë patur permirsim të dukshëm në fushën e komunikimit kjo duke ju referuar dhe programit të përgatitur nga terapistja “Vet-terapi e belbezimit)

5 fëmijë kanë patur permiresim në fushën e autonomise, terapistja ka shperndare tek te 5 prinderit program të vlefshëm për heqjen e pampersit tek fëmijë që e kanë kaluar moshën biologjike të përdorimit të tij.

Permiresime të dukshme kanë patur në fushën e konjicionit, shtimit të numrit të minutave në tavolinen e terapisë, në nderveprim social etj.

10 fëmijë u regjistruan për herë të parë në muajin Shtator në kopshte dhe shkolla me ndihmën e qendrës komunitare (punonjës social dhe menaxheres në përgatitjen e dokumentacioneve të fëmijëve dhe lobimin për të drejtat e fëmijëve për gjithëpërfshirje). Te 10 fëmijet sot kanë mesuese

mbeshtetese ne kopesht dhe shkolla.

3 te rinj ndoqen kursin professional te guzhines dhe sot jane te pajisu me certifikaten e kualifikimit.

Nje nga femijet ne muajin Janar e me tej do ndjeki kursin e estetikes.

29 femije jane referuar per diagnostikim dhe te gjithë jane diagnostikuar.

Llojet e terapise:

Terapi zhvillimi dhe terapi te foluri kane perfituar 53 femije.

Terapi okupacionale kane perfituar 7 femije.

Fizioterapi kane perfituar 10 femije dhe 1 i rritur.

Menaxhim te sjelljes kane perfituar 10 femije

5 femije kane perfituar nga programi javor after school, ku eshte punuar intensivisht per permiresimin e aftesive te tyre akademike.

Trajnimet e prinderve:

Te gjithë prinderit kane marre pjese ne trajnimet qe jane bere ne qender nga ekspert te jashtem mbi menytrat se si duhet te punojne ne shtepi me femijet e tyre.

Mbase cdo terapi terapistet u japin informacion prinderve sit e vazhdojne punen e tyre ne kushtet e shtepise.

b) Rezultatet që prisni

Rezultatet e pritshme janë:

Rritja e numrit të fëmijëve me aftësi të kufizuar që si pasojë e shërbimeve të marra në Qendër, gëzojnë gjithëpërfshirjen dhe aftësohen për jetesë të pavarur,

Rritja e numrit të familjarëve, përfitues të shërbimeve që rritin kapacitetet për të punuar me fëmijet e tyre dhe advokuar për të drejtat e tyre

Aktivizimi i institucioneve dhe komunitetit në mbështetje të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre,

c) Aktorët e mundshëm

Fëmijët në të gjitha çerdhet në Bashkinë Vlore të kenë kushte sa më të favorshme për qëndrimin e tyre.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Vlorë.

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet

**** Shpenzime për personelin (paga + sigurime shoqërore)**

Pozicioni	Nr	Klasa	Page Grupit	Shtesa per pozicion	Vjetersia	Shuma ne Leke
Drejtor	1	III-2	14,000	141,000	25,380	2,164,560
Psikolog	3	IV-3	14,000	70,000	13,300	3,502,800
Punonjes Social	1	IV-3	14,000	70,000	13,300	1,167,600
Edukatore	2	IV-4	14,000	60,000	11,400	2,049,600
Logoped	3	IV-3	14,000	70,000	13,300	3,502,800
Fizioterapist	3	IV-3	14,000	70,000	13,300	3,502,800
Sanitare	1			51,000	12,750	813,000
Shuma	14					16,703,160
Fondi i vecante 5%						835,158

Totali pagave						17,538,318
Sig.shoq						2,789,428
Totali						20,327,746

Shpenzime operative sipas kerkeses se qendres se sherbimeve komunitare per femijet me aftesi te kufizuar, për aktivitete ndergjegjesuese jane si me poshte :

1. Kancelari, terapi zhvillimi, logopedi dhe fizioterapi 590.000 lek
2. Aktivitet per ditën nderkombetare te Autizmit 80.000 lek
3. Aktiviteti per ditën kombetare te femijeve 150.000 lek
4. Aktivitet per ditën nderk te femijeve PAK 130.000 lek
5. Aktivitet per festat e fundvitit 90.000 lek
6. Trajnim Stafi 600.000 lek
7. Shpenzime operative per uje drita dhe mirembajtje 700.000 lek

Totali 2.340.000 lek

Emertimi	Planifikuar mije leke
Paga	17.531
Sig.Shoqerore	2.789
Shpenzime operative	2.340
Totali	22.660

Për vlerësim buxheti leke 22.660 mije leke.

f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.
---	--

Qendra Multifunksionale

Projekti: Qendra Multifunksionale Kodi: III.19.3	Lloji i programit: Familja dhe fëmijët Funksioni: Për fuqizimin e familjeve, gra te dhunuara, fëmijët ne situatë rrugë dhe grupet e tjera vulnerable por edhe edukimin , këshillimin dhe zhvillimin psiko-social të fëmijëve dhe familjeve në nevojë në Bashkinë e Vlorës .
--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

I. Situata

Qendra Multifunksionale është strukture e ngritur ne kuadër te hartimit te Planit Social 2018-2021, i cili është hartuar nga Drejtoria me mbështetjen e UNICEF përmes OJF-ve World Vision dhe ESA Consulting në një fazë të parë dhe Europartners Development në fazën përmbyllëse dhe që synon të krijojë mekanizmat e domosdoshëm administrativë, strukturat institucionale në shërbim të grupeve vulnerable (edukim, shërbim psikologjik etj) të identifikojë kostot dhe burimet financiare, në mënyrë që shërbimet e kujdesit social të ofrohen për fuqizimin e familjeve, gra te dhunuara, fëmijët ne situatë rrugë dhe grupet e tjera vulnerable në Bashkinë e Vlorës, sipas një projekti të hartuar mirë, i cili monitorohet dhe azhurnohet rregullisht. Gjatë kësaj periudhe tre-vjecare dhe pas kësaj periudhe do të alokohen fonde nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga Bashkia Vlorë deri sa qendra do te

kaloje plotësisht e financuar dhe ne administrimin e Bashkisë Vlore .

Qendra Multifunkionale i ofron shërbimet e veta ne ambientet e Godinës pranë konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Pavarësia” Vlorë , ambient i ofruar nga Bashkia Vlorë.

Qendra ofron shërbime nga një ekip multidisciplinar për fëmijët dhe familjet në nevojë, ku numri i përfituesve do te jete ne baze te nevojave , te dyja gjinite , per femijet nga 4-5 vjec deri 18 vjec ndersa per fuqizimin e familjeve , te rriturit mbi 18 vjec.

Përfitues të drejtëpërdrejtë: Familjet e fëmijëve dhe fëmijët e akomoduar në IPSH Vlorë; familjet në risk për tu ndarë nga fëmijët; familje të cilat kanë shfaqur sjellje problematike në mirërritje dhe zhvillimin e fëmijëve etj, (të tjera grupe në nevojë me specifika të ngjashme); punonjësve menaxherë të rastit (PMF), punonjësit e IPSH Vlorë.

Përfitues të tërthortë: rrethi i gjerë familjar i familjeve target; punonjës të strukturave të posaçmetë shërbimeve sociale pranë bashkisë; punonjësit e shërbimit social shtetëror; punonjësit e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit në çdo njësi administrative; profesionistë të tjerë të shërbimeve psikosociale të sitemit shëndetësor dhe arsimor në nivel vendor. Aktivitetet që do të realizohen nga Qendra Multifunkionale janë:

Aktiviteti 1.1: Mbështetje psiko sociale përmes ofrimit të informacionit, këshillimit dhe avokimit.

Aktiviteti 1.2: Organizmi i klasave të prindërimit dhe terapisë familjare, sipas nevojave për secilën familje.

Aktiviteti 1.3: Sigurimi i aksesit në rrjetet e shërbimeve në komunitet

Aktiviteti 1.4. Shërbime për mbështetje ligjore dhe administrative për familjet.

Aktiviteti 1.5. Mbështetje për aftësim profesional, punësim

Aktiviteti 2. Ngritja e ekipit të specialistëve mbështetës për ofrimin e shërbimeve të specializuara

Aktiviteti 3. Ofrimi i kujdesit afatshkurtër në shtëpi.

Aktiviteti 4.1 Identifikim dhe referim për mbështetje, i familjeve të mundshme kujdestare profesionale (me dhe pa lidhje gjaku), në strukturat shërbim ofruese.

Aktiviteti 4.2 Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere për shërbimin e kujdestarisë alternative dhe mirëqënien e fëmijëve

Ky ekip përbehet nga: menaxherja e qendrës, psikolog, punonjës social, edukator, sanitar dhe dy punonjës të Bashkisë në funksion të Qendrës ku një prej tyre do të jetë për Vlerësimin e Rasteve të Nevojave dhe Referimit të Rasteve.

b) Rezultatet që prisni

Rezultatet e pritshme janë:

Rritja e shërbimeve komunitare dhe të integruara të fëmijëve në nevojë që si pasojë e shërbimeve të marra në Qendër, të fuqizohet familja, fëmijët të kenë një jetë më cilësorë , të mos kenë problematika si neglizhimi, mosinteresimi nga ana prindërore etj. Si dhe të gëzojnë gjithëpërfshirjen dhe aftësohen për jetesë të pavarur dhe pa trauma familjare

Rritja e cilësisë së shërbimeve për familjarët e këtyre fëmijëve, përfitues të shërbimeve që rritin kapacitetet për të punuar me fëmijet e tyre dhe advokuar për të drejtat e tyre

Aktivizimi i institucioneve dhe komunitetit në mbështetje të fëmijëve në nevojë dhe familjeve të tyre,

c) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet

** Shpenzime Qendrën Multifunkionale

Pozicioni	Nr	Klasa	Page Grupit	Shtesa per pozicion	Veshtiresi	Vjetersi	Shuma ne Leke
Përgjegjës	1	III-3	14,000	98,000		18,620	1,567,440
Psikolog	2	IV-3	14,000	70,000		13,300	2,335,200
Punonjes Social	2	IV-3	14,000	70,000		13,300	2,335,200
Kujdstare	2	IV-4	14,000	60,000		11,400	2,049,600
Kujdestare Alternative	3		14,000	47,000		8,930	2,517,480
Sanitare	1			51,000	4,000	11,750	800,760
Shuma	11						11,605,680
Fondi I Vecante							580,284
Totali I Pagave							12,185,964
SIG.Shoqerore							1,938,149
TOTALI							14,124,113

Shpenzime operative sipas kërkeses se Qendres Multifunkionale janë 1.650.000 lekë për energji elektrike, ujë, pakete ushqimore dhe pakete higjeno-sanitare.

Emertimi	Planifikuar mije leke
Paga	12.186
Sig.Shoqerore	1.938
Shpenzime operative	1.650
Totali	15.774

Për vlerësim buxheti për vitin 2026 15,774 mije lekë.

c) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026, me fonde të alokuara nga te ardhurat e veta	d) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës. Drejtorja e Ndhmës dhe Shërbimit Social bën monitorimin e shërbimit dhe kapacitetet e stafit që punojnë në Qendër .
--	---

SHTEPIA E FEMIJES

Nr.20	Projekti: Shtëpinë e foshnjës. Kodi:III.20	Lloji i programit: K10430 - Strehim i dhe Shërbimet Sociale
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		

Shtëpia e foshnjës ofron shërbim rezidencial për foshnjat dhe fëmijët e braktisur, jetimë biologjik ose social. Gjithashtu ofron shërbim ditë për foshnjat e fëmijët në nevojë. Shërbimet e ofruara janë nga më të ndryshmet duke filluar nga trajtimi mjekësor, psikosocial për foshnjat, këshillim për nënat, etj. Kapaciteti i këtij institucioni është 30 dhe aktualisht numri i fëmijëve që marrin shërbim në këtë institucion është 10.	
II. Synimi i projektit	
Synojmë krijimin e kushteve sa më të përshtatshme për foshnjat dhe fëmijët që janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit rezidencial.	
III. Aktivitetet kryesore të projektit	
Mbështetje me transport për realizimin e takimeve të fëmijëve me familjet biologjike me qëllim përmirësimin dhe forcim in e marrëdhënies prind-fëmijë. Furnizim me veshmbathje sipas nevojave të fëmijëve Shtëpia e Foshnjës, në mënyrë që të ndihmohet në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar për mirërritjen e fëmijëve të këtij institucioni. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me fëmijët e Institucionit. Hartimi i projekteve të veçanta që mund të paraqiten nga Shtëpia e Fëmijës	
b) Rezultatet që prisni	
Përmirësimi i shërbimit të përkujdesjes, mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve të Shtëpisë së Foshnjës	
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
Institucioni Shtëpia e Foshnjës Fëmijët e sistemuar në institucionet e përkujdesit Familjet e fëmijëve të sistemuar në institucione.	Bashkia Vlorë.
e) Shpenzimet e llogaritura	
Shpenzimet për çdo aktivitet	
Shpenzime operative për shërbim roje 1.920.000 leke. Për vlerësim buxheti 2026 – 1.920 mijë leke	
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Janar 2026	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.

Teatri “Petro Marko”

Nr.15	Projekti : Administrimi dhe Menaxhimi i Teatrit “Petro Marko”	Llojet e programit: K08280. Kultura dhe shërbimet rekreative Funksioni : Fuqizimi dhe rritja e kapaciteteve të institucioneve kulturore dhe artistike të Bashkisë Vlorë
	Kodi : III.2.15	
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Teatri ”Petro Marko” është një institucion varësie i Bashkisë Vlorë. Me një përvojë 63-vjeçare, Teatri “Petro Marko” është një nga institucionet elitë më të rëndësishëm kulturorë në qytetin e Vlorës dhe në rajon, i cili luan një rol të rëndësishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e		

kulturës lokale, duke promovuar identitetin lokal dhe trashëgiminë kulturore. Nëpërmjet rritjes së përfshirjes qytetare aktivitetet kulturore afrojnë komunitetin së bashku, krijojnë ndjenjë përkatësie dhe kontribuojnë në zhvillimin social, ndikojnë drejtpërdrejt në pasurimin e jetës kulturore të qytetarëve. Duke ofruar programe për të rinjtë, promovuar kulturën dhe edukimin përmes aktiviteteve teatrale dhe jo vetëm, ndikon në edukimin dhe zhvillimin personal të tyre duke zhvilluar aftësi si komunikimi, puna në grup dhe kreativiteti. Nuk mund të lëmë pa përmendur, rolin ekonomik dhe turistik si teatër i një qyteti bregdetar me potenciale në rritje të turizmit. Cdo aktivitet i teatrit gjeneron ekonomi lokale, sic mund të jenë shërbime hotelerie, transport, ushqim etj. Duke studiuar kërkesat e viteve të fundit të publikut kryesisht të huaj, teatri mund të shndërrohet në një atraksion turistik, duke patur parasysht pozicionin gjeografik të qytetit dhe historikun e tij si edhe potencialin për aktivitete të nivelit ndërkombëtar.

Çdo aktivitet artistik që ndërmerret është në bashkëpunim dhe me miratim të administratës së bashkisë. Buxheti, niveli i pagave, nivelet e honorareve, etj me propozimin e stafit të Teatrit miratohen nga Bashkia.

Teatri “Petro Marko” ka një strukturë prej 28 personash në të cilën përfshihen drejtori (1), përgjegjësi i financës (1), trupa artistike (që përfshin aktorë, instrumentistë, drejtues muzike dhe solistë) e përberë nga 15 punonjës dhe shërbimet mbështetëse ku përfshihen (fonist, grimier, elektrikistë, teknik skene dhe teknik ndriçimi, sanitare, piktor, marangoz, dhe specialist IMP e përbërë nga 11 persona)

Niveli i pagave është i bazuar në VKM Nr. 1619, datë 2.7.2008, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore”, i ndryshuar

ii. Synimi i projektit

Të arrihen objektivat e vitit 2026 për organizimin e aktiviteteve artistike, me qëllim rritjen e konkurrencës, cilësisë, promovimit të artistëve të rinj dhe gjallërimin e jetës kulturore artistike në Bashkinë e Vlorës.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Pagesa e punonjësve të Teatrit “Petro Marko” (paga bazë)

- Monitorimi i pjesëmarrjes në aktivitetin e përditshëm
- Vlerësimi i performancës në sasi dhe cilësi të stafit

2. Llogaritja dhe pagesa e sigurimeve shoqërore

b) Rezultatet e pritshme

- Promovimi i identitetit lokal dhe trashëgimisë kulturore
- Performancë e përmirësuar dhe zhvillim social
- Shtimi i aktiviteteve kulturore
- Numër spektatorësh i rritur
- Shtim dhe përkrahje e aktorëve dhe instrumentistëve të rinj
- Të ardhura të rritura për institucionin

c) Aktorët e mundshëm

Administrata e Teatrit “Petro Marko”

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia e Vlorës

e) Shpenzimet e llogaritura

Pozicioni	Nr	Klasa	P.Grupi	Pozicion	Vjetersi	Shuma Vjetore
Drejtor	1	II-2	14,000	141,000	21,150	2,113,800

Përgjegjës	1	III-3	14,000	98,000	11,368	1,480,416
Punonjës	13	IV-3	14,000	70,000	18,049	15,919,644
Punonjës	1	IV-3	12,000	70,000	2,100	1,009,200
Punonjës	1	IV-3	10,000	70,000	2,100	985,200
ND/MB	11			51,000	14,645	8,665,195
			PAGA			30,173,455
			Sigurim Shoqëror			5,038,967
			Fond i veçantë			1,508,673

602	Shpenzime Operative	Shuma
1	Shpenzime për energji elektrike	600,000
2	Shpenzime për ujë	90,000
3	Telefon & Internet	80,000
4	Orkestrime	500,000
5	Inçizime	500,000
6	Sigurim objekti	120,000
7	Krijimtari, libret	1,100,000
8	Interpretim, regji	4,000,000
9	Materiale zyre dhe kancelari	120,000
10	Publicitet në media	300,000
11	Mjete promociionale	300,000
12	Fototeka	120,000
13	Garderoba (Veshje)	120,000
14	Mirëmbajtje dhe modelime	120,000
15	Shpenzime për rekuizitën	120,000
16	Shpenzime për dekorin	120,000
17	Shpenzime për skenografi	120,000
18	Shpenzime për materiale pastrimi	120,000
19	Shpenzime për ndriçimin skenes	120,000
20	Shpenzime për foni	120,000
21	Transport dekori dhe trupa	800,000
22	Shpenzime për pastrim kimik	120,000
23	Shpenzime riparimi & shërbime tjera profesionale	120,000
24	Shpenzime blerje aksesorë dhe pajisje profesionale	120,000
25	Abonime	40,000
26	Shpenzime grimi	120,000
27	Mirëmbajtje strukturë godine	120,000
28	Shpenzime lysterje të brendshme	120,000
29	Shpenz.për prodhim dok.specifik (bileta)	120,000

30	Shpenzime për udhëtime (brenda dhe jashtë vendit)	600,000
31	Shpenzime të tjera	200,000
32	Regjistrim shfaqje	120,000
33	Shpenzime për materiale ceremoniale	120,000
34	Shpërblim për aktorët TA nga biletat	900,000
35	Shpenzime për aktivitete artistike	500,000
36	Shpenzime për materiale elektrike	120,000
37	Mirëmbajtje kondicionerët	120,000
38	Shpenzime për materiale hidraulike	120,000
39	Sherbime dhe materiale për mbrotje nga zjarri	120,000
40	Shpenzime për materiale ndertimi	120,000
41	Shpenzime mirembajtje rrejtje dhe kompjuterash	120,000
42	Shpenzimi akomodimi	120,000
	Shuma I	13,750,000

PROJEKTË TË PARASHIKUARA PËR VITIN 2026

1. Festivali i Këngës popullore qytetare “Aromë Portokalli”

Një festival i këngës popullore qytetare vlonjate që përfaqëson një ngjarje kulturore që synon të ruajë, promovojë dhe transmetojë trashëgiminë muzikore të qytetit të Vlorës, me theks të veçantë në këngën qytetare popullore. Kënga qytetare vlonjate është pasqyrë e shpirtit të qytetit të Vlorës, por edhe pjesë e identitetit kombëtar shqiptar, sidomos për rolin e Vlorës në historinë e Shqipërisë (p.sh. Shpallja e Pavarësisë më 1912). Festivali shërben do të shërbejë për Rikthimin e brezave të rinj drejt vlerave tradicionale, Nxjerrjen në pah të interpretuesve të rinj në këngën popullore qytetare, si dhe pasurimin e fondit të këngës qytetare vlonjate. Nëpërmjet tij synohet në pjesmarrje të zgjeruar të kompozitorëve dhe këngëtarëve të këngës qytetare vlonjate, të cilët në përfundim të ndërohen edhe me cmime nga juri prestigjioze. Synimi është që ky Festival të kthehet në një traditë të përvitshme.

2. Konkurs i talenteve të reja “Fest Art 2026”

Ky aktivitet i përvitshëm zhvillohet në Teatrin Petro Marko këtë vit për herë të pestë, i cili ka për qëllim të evidentojë dhe të sjellë në skenë talentet e reja të zbuluara në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit në kategoritë këngë dhe kërcim modern. Organizohet me audicione masive, me grup trainerësh që punojnë më të rinjtë konkurrenës dhe performancë për dy net në skenën e Teatrit Petro Marko. Nga vitet paraardhës është parë se impakti i këtij aktiviteti tek të rinjtë është i jashtëzakonshëm, si dhe ka prodhuar artistë që sot përformojnë në skena kombëtare. Ky projekt ka për qëllim evidentimin e talenteve, shtimin e kapaciteteve artistike për aktivitetet, edukimin e brezit të ri nëpërmjet artit dhe kulturës. Për realizimin e këtij projekti

është siguruar mbështetja e Drejtorisë Vendore Arsimore.

3. Koncert variete "Show veror 2026"

Trupa e artistike e varietesë së Teatrit Petro Marko, në bashkëpunim edhe me dy aktorët e mirënjohur, ikonë të humorit Vlonjat Afrim Agalliu dhe Agron Hamo, zhvillon programin veror me shfaqje të ideuar dhe ndërtuar enkas për sezonin turistik. Projekti është lëvizës në zona të ndryshme, duke u afruar kudo që pushuesit ndodhen. Zgjidhen zona të caktuara ku edhe fluksi i turistëve dhe qytetarëve është më i madh. Është vënë re përfshirja edhe e publikut të huaj, cka ka bërë të këni qasje të re në lidhje me repertorin. Qëllimi i këtij projekti është argëtimi i pushuesve, promovimi i vlerave kulturore të qytetit por edhe vënia në efience e trupës së varietesë për këto muaj.

4. Koncert Gala i Fundvitit

Me rastin e Festave të Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, Teatri Petro Marko ofron një spektakël Gala, traditë e krijuar tashmë cdo vit. Projekti ka për qëllim të paraqesë para publikut vlonjat një mbrëmje gala me një program të përzgjedhur artistik gjithëpërfshirës, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet artistike të qytetit si edhe artistë vlonjatë të afirmuar në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo Gala është perceptuar të jetë një performancë live në të gjithë komponentët e saj. Kjo e bën atë një ngjarje kulturore kulmore me nivel të lartë, që tërheq vëmendjen e publikut dhe medias. Mund të shërbejë edhe si një mbrëmje për të shpërndarë vlerësime për personalitete të spikatura nga Bashkia Vlorë.

5. Një cikël spektaklesh "Fundjava Vlonjate"

Ky projekt përfaqson një ide të re për realizimin e disa spektakleve, gjashtë për vitin 2026, të shtrirë në të gjithë vitin kalendarik. Ka për qëllim tu shtohet aktiviteteve dhe jetës kulturore të qytetit e qe nepermjet shfaqje teatrore, muzikë live, poezi, vallëzim, art skenik, etj, që të zhvillohen në qytetin e Vlorës, në ambientet e Teatrit "Petro Marko". Mendohet të trajtohet në formatin e mbrëmjeve me protagonist artistët tanë vlonjatë, vetëm ose në bashkëpunime, të cilët sot janë pjesë e suksesit në muzikën shqiptare apo në artin dramatik. Ciklet e rregullta me spektakle ndihmojnë në edukimin dhe formimin e një publiku besnik, që pret dhe ndjek aktivitetet artistike. Te zhvilluara ne fundjave, shfrytezojme mundesine e ndjekjes se tyre edhe nga vizitoje qe frekuentojne Vlorën në fundjavë.

PROJEKTË TË PARASHIKUARA PËR VITIN 2026

1. "Festivali i Këngës Popullore qytetare "Aromë Portokalli "

Nr.	Zërat e parashikuar	Vlera sipas zërave
I	<i>Pjesëmarrësit (sipas roleve)</i>	3.335.000
	1- Skenarist x 30.000	30.000
	2- Skenogarf x 60.000	60.000
	3- Regjia x 150.000	150.000
	4- Redaktor muzike 2 x 30.000	60.000
	5- Koordinator x 25.000	25.000
	6 – Prezantues x 30.000	30.000
	7 – Drejtues Orkestre x 60.000	60.000
	8- Udhëheqes artistik x 60.000	60.000
	9 – Krijimtari e re 15 kenge x 50.000	750.000

	10- Formacion orkestral 8 x 50.000	400.000
	11- Këngëtarë 15 x 50.000	750.000
	12- Skena (ndricim& Foni& Ledwall)	300.000
	13- Mjete promocioni & Pub.media	60.000
	14- Juria 5 persona x 30.000	150.000
	15- Shpenzime operative (akom-trans etj)	100.000
	16- Artistë të ftuar	100.000
	17- Post produksion (Editim audio)	250.000
II	TOTAL	3.335.000

2. KONKURSI I ZERA VE TE RINJ “FEST ART 2026”

Nr.	Zërat e parashikuar	Vlera sipas zërave
I	Pjesëmarrësit (sipas roleve)	1.130.000
	1- Trajnerë 3 x 60.000	180.000
	2- Skenogarf x 100.000	100.000
	3- Regjia x 120.000	120.000
	4- Inçizime & Editime master ne studio	150.000
	5- Libret	30.000
	6 - Moderator	50.000
	7- Skena (Foni&Ndrim&Ledwall)	350.000
	8- Anëtare jurie 5 persona	150.000
II	TOTAL	1.130.000

3. KONCERT VARIETE “SHOW VEROR” 2026 , NE PIKA TE NDRYSHME (4 SHFAQJE)

Nr.	Zerat e parashikuar	Vlera sipas zerave
I	Pjesëmarrësit (sipas roleve)	1.350.000
	1- Skena (Podium+Foni+Ndrim+Ledwall)	600.000
	2- Aktore te ftuar parodistat 2x 100.000	200.000
	3- Regjia x 100.000	100.000
	4- Incizime & Editime master ne studio	150.000
	5- Libret	50.000
	6 - Moderator	50.000
	7- Kengetare te rinj	200.000
II	TOTAL	1.350.000

4. KONCERT GALA FUNDVIT (TEATRI PETRO MARKO)

Nr.	Zërat e parashikuar	Vlera sipas zerave
I	Pjesëmarrësit (sipas roleve)	2.040.000

	1- Skena (Foni+Ndrim+Skenografi+Ledwall	<u>550.000</u>
	2- Regjia x 120.000	<u>120.000</u>
	3- Orkestra simfonike 35 pers x 15.000	<u>630.000</u>
	4- Kengetare lirike 3 x 120.000	<u>360.000</u>
	5 – Dirigjent	<u>100.000</u>
	6 – Instrumentiste Soliste 2 x 100.000	<u>200.000</u>
	7 - Libret	<u>30.000</u>
	8 - Moderator	<u>50.000</u>
II	TOTAL	2.040.000

5. KONCERTE VARIETE “FUNDJAVAT VLONJATE”

Nr.	Zerat e parashikuar	Vlera sipas zerave
I	<i>Pjesëmarrësit (sipas roleve)</i>	3.600.000
	1. Formacion orkestral 7 x 50,000	350,000
	2. Artist protagonist i mbrëmjes (këngëtarë , showmen etj)	150,000
	3. Shpenzime të tjera (Publicitet, elemente skenografie)	100,000
		<u>600,000</u>
II	TOTAL 6 Spektakle x 600,000 lek =	3.600.000

Nr rend	Titulli i projektit	Shuma e planifikuar në lek
1	Festivali i këngës popullore qytetare "Aromë Portokalli 2025"	3,335,000
2	Konkursi I zërave të rinj "Fest Art 2025"	1,130,000
3	Koncert variete "Show veror 2025"	1,350,000
4	Koncert Gala I fundvitit	2,040,000
5	Fundjava vlonjate	3,600,000
	ShumaII	11,455,000
	TOTALI I+II	25.205.000

Emërtimi	Planifikuar (mijë lekë)
Paga	30,173
Sig.shoqërore	5,039
Fond i veçantë	1,509

Shpenzime operative (602)	25.205
SHUMA	61.926
INVESTIME (231)	
1. Pajisje zyre, pajisje profesionale, riparime+lyerje	1,000
2. Krijimi i dy tualeteve të reja	2,000
3. Zëvendësimi i dyerve hyrëse në Teatër	700
4. Platformë skenike për evente dhe koncerte	900
SHUMA INVESTIME (231)	4,600
TOTAL	66.526

Për vlerësim buxheti 2026 – 66.526 000/leke

f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.
---	---

Qendra e Kulturës

Nr.14	Projekti: Administrim i dhe menaxhimi Qendrës Kulturore Kodi :III.2.14	Llojet e programit: K08230 - Kultura dhe shërbimet rekreacionale
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Sitata		
Qendra e Kulturës ka strukturën e mëposhtme : Administrata e QK Bibliotekën Publike “Shefqet Musaraj” Muzeu Historik Muzeu Etnografik Galleria e Arteve Kinemaja		
Për funksionimin normal të tyre është I domosdoshëm parashikimi (në bazë të strukture aktuale)i shpenzimeve për paga dhe sigurime.		
ii. Synimi i projektit		
Të rritet cilësia e ofrimit të shërbimit në funksion të pasurimit të jetës artistike, kulturore edukuese për komunitetin.		
iii. Aktivitet et kryesore të projektit		
Përcaktimi i shpenzimeve për Paga dhe Sigurimet 30 punonjësve te Qendrës Kulturore.		
b) Rezultatet që prisni		
Normalitetit në përditshmërinë e aktivitetit të Institucioneve Te Qendrës se Kulturës		
c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt	
Institucionet dhe punonjësit përkatës të Qendrës Kulturore	Bashkia Vlorë	
e) Shpenzimet e llogaritura		

Pozicioni	N	Klasa	Paga	Shtesa për	Vjetërsia	Shuma Vjetore
-----------	---	-------	------	------------	-----------	---------------

Drejtor	1	II-2	14,000	141,000	33,840	2,266,080
Përgjegjës, Financier	4	III-3	14,000	91,000	21,840	6,088,320
Punonjes Metodist(Pallati Kultures)	4	IVB	14,000	60,000	14,000	4,224,000
Punonjës(Shpjegues Muzeu ,Teknik Bibloteke,kurator Galeria,Korograf)	11	IV-3	14,000	70,000	15,000	13,068,000
Punonjës ND/MB	11			51,000	9,000	7,920,000
Totali	30					33,566,400
Fondi I vecante						1,678,320
Totali I pagave						35,244,720
Sigurime shoqerore 16.7%						5,605,588
Totali paga dhe sig shoq						40,850,308

Shpenzime operative		
Nr	Emërtimi	Vlera 000/lek
1	Shpenzime telefonike	200
2	Shpenzime për energjinë elektrike	1,300
3	Shpenzime për ujë	400
4	Shpenzime për abonime	200
5	Shpenzime për blerje librash.	400
6	Shpenzime për material pastrimi	200
7	Shpenzime për riparime dhe shërbime emergjente mirmbajtje	600
8	Shpenzime emergjente për blerje materiale te ndryshme	600
9	Publicitete, reklama, transmetime, njoftime.	300
10	Blerje Kancelari	200
11	Shpenzime Orkestra Frymore	3,500
12	Orchestra e harqeve dhe simfonike + Ansamblet Folk	2,000
13	Teatri i kukullave për fëmijë+Shfaqe cdo Fundjave	800
14	Te tjera aktivitete	400
15	Aktivitete "Art & Youth Fest " Shkollave te mesme	1,000
16	Projekti KOLONIA PIKTOREVE	700
17	Aktivitete Artistike ne Natyre gjate sezonit turistik	1,500
18	Shpenzime për mjete promocionale	120
19	Festivale me grupe nga gjithë qytetet “Nentori I Pavarsise”	2,000
20	Shpenzime udhëtime e dieta për aktorët ne Asamble Folklorike dhe Festivale Kombetare dhe Nderkombetare.	2,000
21	Sigurim ndërtese	200
22	Shpenzime për mjete kundra zjarrit	120
23	Te ndryshme	500
	Shuma	19,240

Investime	Shuma 000/lek
1.Restaurim Zyra e Drejtorise Pallati Kultures (Parket , Kompjuter , Pajisje zyre , Printer)	1,000
2. Blerje për Sallën e Keshillit (Perde + Kondicioner)	1,000
3. Raftë Ekspozimi Muzeu	300
4.Raftë ekspozimi Biboteka , Tavalina ,Karrige , PC	1,000
5.Kostume Folklori	800
TOTALI INVESTIME	4,100

Emërtimi	Planifikuar/mije leke
Paga + Fondi Vecante	35,245
Sig.Shoqerore	5,605
Shpenzime operative	19,240
Investime(Pajisje)	4,100
Totali	64,190
Për vlerësim buxheti 2026 –	64,190 mijë lek
f) Periudha e zbatimit Gjatë gjithë vitit.	g)Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Përgjegjësit përkatës te Institucioneve

SPORTET

Nr. 13	Projekti: Menaxhimi i Klubit Shumësportësh “Flamurtari” Kodi: III.2.13	Llojet e programit K08130: Rinia dhe sportet Funksioni: Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrim i shkurtër i projektit		
i. Situata		
Formimi dhe veprimtaria e shoqërisë sportive “Vlora” e ka zanafillën nga fillimet e shek.XX, rreth vitit 1911. Një i ri vlonjat, Theodhori Arapi, arriti të grumbulloje 32 lojra popullore me karaktere të ndryshme duke zënë vendin e parë në konkursin që u zhvillua në Boston Massachusetts të Sh.B.A. Por mbetemi në sporte të veçanta deri pas krijimit të shoqërisë “Vlora” më 27.03.1923 me kryetar Milto Korcanin. Aktivitet zyrtarë, si Kampionati Kombëtar, filluan ne vitin 1929		
ii. Synimi i projektit		
Përmes përmirësimit të menaxhimit të Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, synohet dhe arritja e rezultateve edhe më të larta për disiplinat përkatëse. Sigurimi i infrastrukturës mbështetëse dhe bazës materiale për zhvillimin e proceseve stërvitore për të gjitha ekipet e klubit shumësportësh		
iii. Aktivitetet kryesore të projektit		
• Pagesë e faturave të energjisë elektrike dhe të ujit për të gjithë ambientet ku stërviten të gjitha ekipet e Klubit Shumësportësh “Flamurtari” • Pagesa e federimit për marrje pjesë në aktivitete zyrtare për pjesën më të madhe të sportistëve të Klubit Shumësportësh • Krijimi i kushteve për zhvillimin normal të aktiviteteve stërvitore dhe ndeshjeve për kampionat për të gjitha disiplinat.		

- Objektivi për vitin 2026 do të jetë pjesëmarrja e sa më shumë ekipeve dhe sportistëve të Klubit Shumësportësh në aktivitetet kombëtare, ndërkombëtare dhe përfaqësimi sa më dinjitoz i ekipeve tona.

b) Rezultatet që prisni

Rezultate të larta të ekipeve dhe sportistëve të Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, si dhe një përfaqsim dinjitoz i Klubit dhe Bashkisë Vlorë.

Realizimi i të ardhurave për vitin 2026 nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, nga dhënia me qera e ambienteve sipas tarifave të përcaktuara parashikohet të jetë në vlerën 400,000 lekë.

c) Aktorët e mundshëm

Bashkia Vlorë.

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Vlorë.

e) Shpenzimet e llogaritura

Pozicioni	Klasa	Kateg	Diploma	Pozicion	Vjetërsi	Paga vjetore
Drejtor	II-2	1	14,000	141,000	141,000+24%	2,266,080
Financier	III-3	1	14,000	98,000	98,000+ 24%	1,626,240
Specialist MP	IV-3	1	14,000	70,000	70,000+ 24%	1,209,600
Inspektor + mjek ekipi	IV-4	5	14,000	60,000	60,000+ 24%	5,304,000
ND/MB		9		51,000	47,000+ 1%	6,777,000
Total		17				17,182,920
Fond i vecante 5%						859,146
Sigurime shoq						2,869,548
Totali						20,911,614

Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/ lekë)	Nga këto:	
		Lekë	Operative	Kapitale
A. 1	Energji elektrike		500	
A.2	Ujë		250	
A. 3	Telefoni+Shërbim internet		80	
A.4	Shpenzime për materiale promocionale		100	
A.5	Shpenzime për publicitet në media		100	
A.6	Shpenzime për aktivitete sportive		100	
A.7	Shpenzime për mirëmbajtje e koshave të basketbollit		100	
A.8	Shpërbim për ekipe dhe individ kampion		1,500	
A.9	Grumbullim të ekipeve për trofe		1,000	

A.10	Federime+Gjyqtari sportive		3,000	
A.11	Shpenzime të paparashikuara		200	
A.12	Udhëtime dhe dieta personeli		200	
A.13	Shpenzime për materiale kancelarike		100	
A.14	Shpenzime për materilae pastrimi		100	
A.15	Shpenzime për bojëra printeri		100	
A.16	Shpenzime për materile hidraulike		100	
A.17	Shpenzime për materilae elektrike		100	
A.18	Shpenzime për bojëra dhe lyerje ambientesh		100	
A.19	Shpenzime për perde		100	
A.20	Materiale për mirëmbajtje dhe riparime		100	
A.21	Shpenzime për dezinfektim ambientesh		100	
A.22	Shpenzime për mirëmbajtje rrjeti dhe kompjuterash, fotokopje		100	
A.23	Shpenzime për materiale funksionim paisje zyre		100	
A.24	Shpenzime për uniforma sportive		1,000	
A.25	Blerje topa për ekipet		120	
A.26	Blerje materiale sportive për ekipin e boksit		120	
A.27	Blerje materiale per ekipin e peshëngritjes		120	
A.28	Blerje materiale sportive për ekipin e qitjes		120	
A.29	Sigurimi I lojtarëve		600	
A.30	Shpenzime bileta udhëtimi per transferim lojtarësh te huaj		1,000	
A.31	Mbështetje për ekipet e Klubit Shumësportësh		43,000	
	Shuma		54,310	

Për vlerësim buxheti 2026 – 75,222 mijë leke

f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026	g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit : Zyra e financës, drejtori.
---	---

Nr.2	Projekti: Mbështetje e ekipit të basketbollit meshkuj të rritur Kodi: III.2.10.2	Llojet e programit K0840: Rinia dhe sportet Funksioni: Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
i. Situata		
• Ekipi i basketbollit të meshkujve është pjesë e këtij klubi që prej vitit 1940 dhe merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregullores të FSHB. • Përbëhet nga 18 sportiste, 2 trajner dhe 1 zv/trajner		
II. Synimi i projektit		

Synojmë që të krijohen kushtet optimale për arritjen e objektivave të përcaktuar nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”

III. Aktivitetet kryesore të projektit

- Sigurimit të kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit. Sigurimi i bazës materiale si: uniforma sportive, topa, kosha, etj.
- Trajtim ushqimor për sportistët
- Pagesë me honorarë të trajnerëve.
- Dieta për ekipin.

b) Rezultatet që prisni

Krijimi i kushteve sa më të mira për zhvillimin e stërvitjes së ekipit të basketbollit, me qëllim arritjen e objektivave të ekipit. Për vitin 2026 ekipi i të rriturve Flamurtari ka si objektiv primar vendin e parë të Kategorisë së parë, ngjitjen në Superligë dhe fitoren e Kupës së Shqipërisë

c) Aktorët e mundshëm

Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, Bashkia Vlorë

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Vlorë

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/lekë)		Nga këto:	
		Lekë	Paga sig.	Operative	Kapitale
A. 1	Trajtime ushqimore	5,000		5,000	
A. 2	Dieta ekipi				
A.3	Pagesa honorarë (trajnerë)				
	Total				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			

Nr.3	Projekti: Mbështetje e ekipeve të basketbollit meshkuj të rinj (U18/U16) Kodi: III.2.10.3	Llojet e programit K0840: Rinia dhe sportet Funksioni: Organizimi i aktiviteteve sportive
------	--	--

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit

i. Situata

- Ekipi i basketbollit të rinjve U18 për meshkuj “Flamurtari” përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner.
- Ekipi i basketbollit të rinjve U16 për meshkuj “Flamurtari” përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner.
- Ekipi i basketbollit të rinjve për meshkuj “Flamurtari” ka fituar Kupën e Shqipërisë në vitin 1989
- Në përbërjen e tyre ekipet e basketbollit të të rinjve për meshkuj “Flamurtari” kanë lojtarë të rinj me perspektive dhe talent që në të ardhmen do të jenë burim për ekipin e të rriturve

II. Synimi i projektit

Synojmë që të krijohen kushtet optimale për arritjen e objektivave të përcaktuar nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”

III. Aktivitetet kryesore të projektit

- Sigurimit të kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit. Sigurimi i bazës material si: uniforma sportive, topa, kosha, etj.
- Trajtim ushqimor për sportistët
- Pagesë me honorarë të trajnerëve.

b) Rezultatet që prisni

Krijimi i kushteve sa më të mira për zhvillimin e stërvitjes së ekipit të basketbollit për të rinj, me qëllim arritjen e objektivave të ekipit. Objektivi për vitin 2026 është promovimi dhe rritja e pjesëmarrjes në këtë sport nga nxënësit e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Vlorës. Kjo bën të mundur nxitjen e të rinjve për të marrë pjesë në aktivitete sportive dhe zbulimin e talenteve të reja për ekipin e të rriturve.

c) Aktorët e mundshëm

Klubi Shumësportësh "Flamurtari", Bashkia Vlorë

d) Kontributet e mundshme në projekt

Bashkia Vlorë

e) Shpenzimet e llogaritura

Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/lekë)		Nga këto:	
		Lekë		Operative	Kapitale
A. 1	Trajtime ushqimore	500		500	
A.2	Dieta ekipi				
A.3	Pagesa honorarë (trajnerë)				
	Total				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			

Nr.4	Projekti: Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të rritura Kodi: III.2.10.4	Llojet e programit K0840: Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
Është ekipi me më shumë trofe në Klubin Shumësportësh "Flamurtari", ku numëron • 22 Tituj kampion • 23 Kupa Republike • 16 Superkupa • 6 Kupa Federate • Përbëhet nga 17 sportist dhe 3 trajnerë		
II. Synimi i projektit		
Sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin e aktiviteteve sportive të ekipit të basketbollit të të rriturve me qëllim fitoren e titullit kampion edhe për vitin 2026.		
III. Aktivitetet kryesore të projektit		
• Sigurimi i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit. • Pagesë me honorarë të trajnerëve. • Dietat, në udhëtimet e ekipit në qytete jashtë Vlorës • Trajtim ushqimor të sportistëve dhe trajnerëve..		

b) Rezultatet që prisni					
Ekipi i basketbollit të të rriturave për femra të arrijë objektivat e përcaktuara nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari ”. Fitorja e titullit Kampion për sezonin 2025-2026 si dhe të Kupës së Shqipërisë, Superkupës dhe fitoren e Ligës Unikë sezoni 2025-2026.					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, sportdashësit, Bashkia Vlorë			Bashkia Vlorë.		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet			Totali(000/lekë)		Nga këto:
		Lekë		Operative	Kapitale
A.1	Trajtim Ushqimor	9,500		9,500	
A. 2	Dieta ekipi				
A.3	Pagesa honorarë (trajnerë)				
	Totali				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026			g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.		

Nr.5	Projekti: Mbështetje e ekipit të basketbollit femra të reja (U18/U16) Kodi: III.2.10.5	Llojet e programit: K0840 - Rinia dhe sportet Funksioni: Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
- Ekipi i basketbollit të reja për femra “Flamurtari”, U18 përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner. - Ekipi i basketbollit të reja për femra “Flamurtari”, U16 përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner. - Në përbërjen e tyre ekipet e basketbollit të të reja për femra “Flamurtari” kanë lojtare të reja me perspektive dhe talent që në të ardhmen do të jenë burim për ekipin e të rriturave		
II. Synimi i projektit		
Sigurimi i kushteve optimale për zhvillimin e aktiviteteve sportive të ekipit të basketbollit të reja për femra “Flamurtari”. Organizimi i aktiviteteve sportive në nivel lokal në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Vlorë dhe trajnerët e Klubit Shumësportësh, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete sportive dhe zhvillimin e masivizimin e sportit në Bashkinë Vlorë.		
III. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Sigurimi i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit. - Pagesë me honorarë të trajnerëve. - Dietat, në udhëtimet e ekipit në qytete jashtë Vlorës		
b) Rezultatet që prisni		
Ekipi i basketbollit të të reja për femra të arrijë objektivat e përcaktuara nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”. Objektivi për vitin 2026 është promovimi dhe rritja e pjesëmarrjes në këtë sport nga nxënëset e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të qytetit të Vlorës.		

c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt			
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, sportdashësit, Bashkia Vlorë		Bashkia Vlorë.			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali(000/lekë)		Nga këto:	
		Lekë	Paga sig.	Operative	Kapitale
A. 1	Dieta ekipi	800		800	
A.2	Pagesa honorarë (trajnerë)				
	Totali				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			

Nr.6	Projekti: Mbështetje e ekipit të volejbollit femra të rritura. Kodi: III.2.10.6	Llojet e programit: K0840 : Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive
------	--	---

a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**I. Situata**

- Ekipi i volejbollit “Flamurtari”, si pjesë e Klubit Shumësportësh “Flamurtari” merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregulloreve të FSHV.
- Ekipi i të rriturave i Flamurtarit përbëhet nga 15 sportistë dhe 2 trajnerë.

II. Synimi i projektit

Mbarëvajtja e ekipit të volejbollit me qëllim rritjen e cilësisë sportive dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

III. Aktivitetet kryesore të projektit

- Sigurim i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit. Sigurimi i bazës materiale si: topa, këpuce, komplete sportive, rrjeta volejboli, etj;
- Trajtim ushqimor të sportistëve dhe trajnerëve;
- Pagesë me honorarë të trajnerëve.

b) Rezultatet që prisni

Kushtet e mira për stërvitjen e ekipit, ndikojnë në arritjen e objektivave të ekipit të volejbollit të të rriturave për femra. Synimi për vitin 2026 arritja e vendit të parë në Kategorinë I dhe ngjitja në Superligë.

c) Aktorët e mundshëm	d) Kontributet e mundshme në projekt
------------------------------	---

Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, Bashkia Vlorë, sportdashësit.		Bashkia Vlorë			
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/lekë)		Nga këto:	
		Lekë	Paga sig.	Operative	Kapitale
A. 1	Trajtime ushqimore	3,000		3,000	
A.2	Pagesa honorarë (trajnerë)				
A. 3	Dieta ekipi				
	Total				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			

Nr.7	Projekti: Mbështetje e ekipit të Volejbollit femra të reja Kodi: III.2.10.7	Llojet e programit : K0840 - Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
• Ekipi i volejbollit të rinjve për femra “Flamurtari”, si pjesë e Klubit Shumësportësh “Flamurtari” merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në baze të rregulloreve të FSHV; • Ekipi i të rejave U16 përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner; • Ekipi i të rejave U18 përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner; • Ekipi i të rejave U20 përbëhet nga 18 sportistë dhe 1 trajner.		
II. Synimi i projektit		
Krijimi i kushteve optimale të stërvitjes për ekipin e volejbollit të rinjve për femra në mënyre që të arrihen objektivat e ekipit.		
III. Aktivitetet kryesore të projektit		
• Sigurimi i kushteve të stërvitjes në palestren e qytetit. • Sigurimi i bazës material uniforme, topa, rrjeta, etj. • Pagesa me honorare të trajnereve. • Dieta për ekipin në transfertë.		
b) Rezultatet që prisni		
Ekipi i volejbollit i të rejave për femra realizon objektivat e përcaktuara nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”. Për vitin 2026 ekipi synon të shpallet kampion.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
Klubi Shumësportësh “Flamurtari” sportdashësit, Bashkia e Vlorë.		Bashkia e Vlorës

e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/lekë)		Nga këto:	
		Lekë	Paga sig.	Operative	Kapitale
A.1	Diete ekipi	800		800	
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)				
	Totali				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			
Nr.8	Projekti: Mbështetje e ekipit të Volejbollit meshkuj të rinj Kodi: III.2.10.8	Llojet e programit : K0840 - Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
I. Situata					
- Ekipi i volejbollit meshkuj të rinj “Flamurtari”, si pjesë e Klubit Shumësportësh “Flamurtari” merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në baze të rregulloreve të FSHV; - Volejbollit meshkuj të rinj përbëhet nga 12 sportistë dhe 1 trajner;					
II. Synimi i projektit					
Krijimi i kushteve optimale të stërvitjes për ekipin e volejbollit të të rinjve për meshkuj në mënyre që të arrihen objektivat e ekipit.					
III. Aktivitetet kryesore të projektit					
- Sigurimi i kushteve të stërvitjes në palestren e qytetit. - Sigurimi i bazës material uniforme, topa, rrjeta, etj. - Pagese me honorare të trajnereve. - Dieta për ekipin në transfertë.					
b) Rezultatet që prisni					
Ekipi I volejbollit të të rinjve për meshkuj të realizojnë objektivat e përcaktuara nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”.					
c) Aktorët e mundshëm			d) Kontributet e mundshme në projekt		
Klubi Shumësportësh “Flamurtari” sportdashësit, Bashkia e Vlorë.			Bashkia e Vlorës		
e) Shpenzimet e llogaritura					
Shpenzimet për çdo aktivitet		Totali (000/lekë)		Nga këto:	

		Lekë	Paga sig.	Operative	Kapitale
A.1	Diete ekipi	300		300	
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)				
	Totali				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës, drejtori.			

Nr.9	Projekti: Mbështetje e ekipit të boksit. Kodi: III.2.10.9	Llojet e programit : K0840 - Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit		
I. Situata		
- Ekipi i boksit “Flamurtari “ si pjesë e Klubit Shmësportësh “Flamurtari ” që prej vitit 1944 merr pjesë në të gjitha veprimtaritë kombëtare në bazë të rregullores të FSHB; - Deri ne vitin 2000 ekipi “Flamurtari” shpallet Nënkampion i vendit; - Shpallet Kampion Kombëtar në Tetor te vitit 2001; - Në vitin 2002, fitues i Kupës së Republikës; - Në vitin 2003 ekipi “Flamurtari “ është fitues i Kupës së Republikës; - Ne vitin 2003 shpallet ekipi i të rinjve të “Flamurtarit “ Kampion Kombëtar; - Ne vitin 2025 shpallet me 3 Kampion Kombëtar 2 vende të dyta dhe një vend të tretë; - Shpallet Nënkampion Kombëtar për vitin 2025; - Ekipi i të rriturve i Flamurtarit përbëhet nga 16 sportistë dhe 2 trajnerë.		
II. Synimi i projektit		
Krijimi i kushteve optimale për zhvillimin e stërvitjes së ekipit të boksit.		
III. Aktivitetet kryesore të projektit		
- Sigurimi i kushteve të stërvitjes në pallatin e sportit; - Sigurimi i bazës materiale si: Doreza boksi, uniforma sportive, etj; - Trajtim ushqimor të sportistëve dhe trajnerëve; - Pagesë me honorare të trajnerëve; - Dieta për ekipin në transfertë.		
b) Rezultatet që prisni.		
Ekipi i boksit atë arrijë objektivat e vendosura nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari” . Objektivi për vitin 2026 është fitorja e titullit kampion, marrja pjesë në aktivitete ndërkombëtare dhe përfaqsimi i denjë i Klubit Shumësportësh Flamurtari.		
c) Aktorët e mundshëm		d) Kontributet e mundshme në projekt
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”, sportdashësit, Bashkia Vlorë.		Bashkia Vlorë
e) Shpenzimet e llogaritura		
Shpenzimet për çdo aktivitet	Totali (000/lekë)	Nga këto:

		Lekë		Operative	Kapitale
A. 1	Trajtime ushqimore	5,000		5,000	
A.2	Pagesa honorare (trajnerë)				
	Shuma				
f) Periudha e zbatimit 1 Janar 2026 deri 31 Dhjetor 2026		g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: Zyra e financës,drejtori.			

Nr.10	Projekti: Mbështetje e ekipit të Çiklizmit Kodi: III.2.10.10	Llojet e programit: K0840 - Rinia dhe sportet Funksioni : Organizimi i aktiviteteve sportive			
a) Përshkrimi i shkurtër i projektit					
I. Situata					
